



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.3(440)

MARS 2025

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

**IN MEMORIAM**



**FEHMI AGANI,  
ROL KYÇ NË  
PROCESIN  
POLITIK TË  
KOSOVËS**

Nga Bashkim Hisari

FAQE 5

**105 VJETORI I LINDJES**

**HALIL VELI BALA, BIR I DENJË I  
SHKODRËS DHE SHQIPËRISË!**



Nga Xhevat Mustafa

FAQE 9

**ANALIZA**



**KRIZA  
MORALE DHE  
MENDIMI  
FILOZOFIK I  
MARK ZADESË**

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 4

*REAGIMI/ OBVL, organizata e parë dhe e vetme e veteranëve pas përmbyesjes së diktaturës*

# E VËRTETA E ORGANIZIMIT TË VETERANËVE TË LANÇ

**KORRUPSIONI  
ZGJEDHOR, OBVLP  
MBËSHTET  
STRATEGJINË E SPAK**

**Halil RAMA**  
Kur na ndajnë vetëm dy muaj nga zgjedhjet parlamentare të 11 Majit 2025, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe pasardhëseve (OBVLP) konsideron sfidë madhore të institucione shqiptare ligjzbatuese parandalimin e ndikimit të krimit të organizuar dhe luftën pa kompromis kundra krimit zgjedhor. Kjo, për faktin se konkluzionet e raporteve ndërkombëtare mbi zgjedhjet e zhvilluara në periudhën 2021-2023 evidentojnë si probleme kryesore blerjen e votave, keqpërdorimin e burimeve publike dhe presion ndaj votuesve, veçanërisht ndaj punonjësve të administratës shtetërore; cënimin e sekretit të votës dhe paanshmërinë e medias.

FAQE 10

Halil RAMA & Sakip CAMI

**30 VJET OBVL**

HISTORI SUKSESI

ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE DHE PASARDHËSVE TË VETERANËVE TË LANÇ

Monografi - korrik 2024

• Gjashtëdhjetëkatër firmëtarët e krijimit të OBVL, ish komandantë e komisarë, gjeneralë Heronj të Popullit, pjesmarrës në Luftën, Nc. Çl, me Platformën e shpalljes së saj me datën 27 Korrik 1994, publikuan THIRRJEN PËR BASHKIMIN E TË GJITHË VETERANVE NË NJË ORGANIZATË TË VETME

FAQE 4

**81 VJETORI**

**BRIGADA E VII-TË  
SULMUESE, 120 BETEJA  
DHE 3200 KILOMETRA  
MARSHIME**

FAQE 2

**104 VJETORI I ARMËS SË XHENIOS**

**LAVDI 5 HERONJVE, DHE  
160 DËSHMORËVE TË  
ARMËS SË XHENIOS**

Nga Zabit Çuku

FAQE 11

**IN MEMORIAM**

**SKËNDER MUÇO,  
NJERIU QE I DHA EMER  
HISTORISË**

DAUT HOXHA

FAQE 8

**PROFILI**

**XHEZO PRODA  
DËSHMOR I ATDHEUT,  
KRENARI E KOMBIT SHQIPTAR**

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 6

**ESSE**

**DËSHMORI SINAN  
LAME LIZA, TRUPE SHPIRT,  
PËR LIRI!**

Neki ÇAKO

FAQE 7

**PORTRET**

**IRFAN LULO,  
PEDAGOGU SHEMBULLORI I  
ARTILERISË**

Zef RROZHANI

FAQE 10

**PROMOVIMI**

*Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu përshëndet pjesëmarrësit dhe vlerëson veprën dinjitoze të akademik Vasil S. Tole*

**U PROMOVUA LIBRI “DHORA  
LEKA KOMPOZITORJA E PARË”**

Merrnin pjesë edhe Kryetarja e OBVLP Tatjana Parllaku-Çarkaxhiu, nënkryetari Kolonel Trifon Llupo dhe drejtues të tjerë të kësaj organizate

FAQE 16

**SUPLEMENTI LETRAT**

**HERONJTË E LUFTËS PARTIZANE  
TË LABËRISË**

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

F. 14

**ROSELA JAKU KODRA DHE LIBRI I  
SAJ PËR GJYSHEN**

Nga Sakip Cami

F. 12-13

**NJË ENCIKLOPEDI NDRYSHE NGA  
BERAT LUZHA**

Ismet Balaj

F. 15

81 VJETORI

# Brigada e VII-të Sulmuese, 120 beteja dhe 3200 kilometra marshime

**M**e urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, më 17 mars 1944, në Vlush të Skraparit u formua Brigada e VII Sulmuese (Br.VII S). Në rreshtat e brigadës u rreshtuan partizanë me eksperiencë në luftë të batalioneve të qarkut të Beratit, të Grupit të Skraparit, të batalionit të rinisë "Margarita Tutulani" etj. Erdhën gjithashtu dhe mjaft partizanë nga qarku i Gjirokastrës dhe nga qarku i Korçës. Në komandë të brigadës u emëruan: komandant Gjin Marku dhe pas Musa Daci; komisar Kadri Hoxha dhe më vonë oficer karriere, Qazim Kapisyzi. Kuadro dhe luftëtarë ishin dhe Adil Çarçani, zëvendës-komisar, Ramiz Alia përgjegjës i rinisë i brigadës, etj. Situata në të cilën u krijua Br. VII S ishte shumë më e favorshme nga ato në të cilat u krijuan Br. V-VI S.

81 vjetori i krijimit të Brigadës së VII-të na kujton disa nga kuadrot që përmendëm më lart, të cilët përbëjnë bërthamën e kuadrove politikë si Adil Çarçani, Myqerem Fuga, Niazi Demi, Tajar Grepcka, Ramiz Alia, Nexhmedin Ballka etj. Më vonë dolën kuadro drejtuese të kompanive të kësaj Brigade, komunistë që ashtu si e nënvizon Myqerem Fuga, u bënë promotori i celulave të kompanive dhe dhanë një kontribut të madh në forcën goditëse të Brigadës, si Foto Çami, Koli Myzeqari, (dëshmor), Skënder Libohova (dëshmor), Guçe Stropani etj.

## ROLI I GJIN MARKUT

Me të marrë urdhërin, Gjin Marku iu vu punës organizuese të kësaj Brigade. Në shtëpinë e Kahreman Yllit, në prani të Myqerem Fugës u bë organizimi i Brigadës ashtu si është dhënë në historik. Batalioni i Parë u formua kryesisht me partizanë të Qarkut të Beratit me një kompani nga Devolli; Batalioni i Dytë kryesisht me partizanë të grupit të Skraparit, ndërsa Batalioni i Tretë u formua nga partizanë të Qarkut të Gjirokastrës, me në krye Gani Nivicën (dëshmor), me një kompani nga Batalioni i Dëshnicës.

Ceremonia u zhvillua më 17 mars 1944 në fshatin Vlushë të Skraparit, në atë fshat, ku dy muaj më parë nazistët gjermanë vranë 114 skraparillinj, duke përfshirë edhe ata të fshatrave Krushovë, Kapinovë e Turbehovë. I njëqindesëmbëdhjeti, Veseli, rrojti, jetoi, për t'u treguar ditëve të pasçlirimit tmerret e luftës dhe vuajtjet e atij populli liridashës.

"Vlusha vlon", "Stalini sulmon". Këto ishin parrulla e kundërparrulla të natës së parë, drejt aksionit, drejt Beratit. Në garnizonin e Beratit e kryesisht në Kuçovë kishte pak gjermanë, kryesisht kishte forca të Ballit Kombëtar dhe të Gjindarmërisë. Mbrojtja ishte orga-



nizuar kryesisht me pikëmbështetje të forta. Mund të përmendim Kallanë, Shëndëllinë, Lisin e Beçit dhe vetë kazemat ushtarake. Kuçova, vetë fusha e Otlakut dhe Ura Vajgurore kishin të tjerë garnizone mbrojtje. Këto objekte, të lidhura me copa transhe dhe hendeklidhje përbënin një mbrojtje të fuqishme, me të cilat do të përballlej Brigada e VII-të. Sekretin e armikut qëndronte në shumëllojshmërinë e pozicioneve të zjarrit. Disa nga këto ishin të pushtuara dhe disa jo. Tanket nuk qëndronin në qytet. Ato afroreshin pranë kazermave vetëm kur partizanët e Brigadës së VII-të e rrezikonin qytetin. Pas urdhërit të Komandantit vinin urdhëra të tjerë, të nënshkruara nga Spiro Moisiu për çlirimin e Beratit, për përballimin e Operacionit të qershorit, për çlirimin e Beratit dhanë ndihmesën e tyre vetë beratasit. Qysh në goditjen e parë mbi harkun e parë mbrojtës ra partizani Thoma Shqina, një nga të rinjtë e zjarrtë të këtij qyteti. Po atë ditë ra Rahmi Stropani nga treva atdhetare e Devollit. Nuk mund të numërohen aktet heroike të partizanëve nga Zona e Skraparit dhe e Dëshnicës.

Në faqet e historisë së Brigadës së VII-të Sulmuese radhiten shumë partizanë e kuadro që ranë në ballë të luftës. Po përmendim disa nga kuadrot drejtuese politikë: Koli Myzeqarin, Skënder Libohova, komandant batalioni, Haxhi Dokon, Fahri Zaimin, Mehdi Vilën, Loni Odriçanin, Thimi Tanin, Naim Gurin, komisar kompanie.

## LUFTIMET E BRIGADËS

Brigada luftonte dhe rritej në numër. Gjatë rrugës luftarake u shtua dhe me dy batalione të tjerë.

**• Brigada e VII-të Sulmuese ishte një nga brigadat më të shquara të Frontit Nacionalçlirimtar gjatë fundit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Komandanti ushtarak ishte Gjin Marku dhe komisar politik Kadri Hoxha**

Forcat pushtuese nuk u ndjenë mirë dhe komandanti i Xhandarmërisë Mbretërore me informacionin nr.94/6, datë 18.3.1944 i drejtohej Ministrisë së Punëve të Brendshme:

"Në rajon gjendja paraqitet kritike. Çetat komuniste të Skraparit kanë mobilizuar krejt banorët e atij rrethi dhe kanë formuar Brigadën e shtatë komuniste. Kështu që fuqia e tyre arrin deri në 1000 veta." Në të vërtetë edhe pse brigada la në fushën e betejës 302 dëshmorë, arriti numrin në 2229 partizanë. Ata 142 partizanë që u plagosën, u mjekuan nëpër spitalet partizane dhe u kthyen sërish në luftë, të cilën e vazhduan deri në Vishegrad. Kur i hedh një sy korrespondencës me të cilën funksiononte brigada, çuditësh. Si nuk janë rrezikuar ata korrierë, që kalonin nëpër plumba? Ato janë shkruar rrëzë shkurreve e ulur nëpër gurë, se ato ishin tryezat e luftëtarëve. Një letër është shkruar në fshatin Duhanas të Beratit, një tjetër në Karkanjoz në mes të dimrit. Dallohen ende pikat e shiut që kanë rënë mbi to. "Deri sot në Tomorr

ndodhen edhe skuadra të brigadës VII. Armiku ndodhet i përqendruar në Qahajas, Vodicë, por i mbërthyer në vend dhe pa iniciativë. Sasia e tyre mbërrin deri 300 veta mercenarë të veshur dhe ballistë të vendit. Më datën 6, pjesa e Brigasës VII largohet prej këtej në drejtim të Skraparit dhe këtu mbeten forca të vendit, të cilat do të patrullojnë. Në mbrëmjen e datës 5 ndonjë kompani të mbërrin në Tomorr ku do të marrë ndërlidhje. Skuadrat le të ulen në Perisnakë për të qenë si presion për armikun. Në datën 6 do të jemi edhe ne në Tomorr për t'u takuar me ju, pra ju presim...Te fala shoqërore Komandanti Shtabit, Mestan Ujaniku, zëvendëskomisar, Kahreman Ylli."

Lëvizja Nacionalçlirimtare nuk ishte thjeshtë luftë, por një shkollë nga mësuat 312 partizanë anal-fabetë. Që nga lufta dolën kuadrot që drejtuan ekonominë në fillimet e rindërtimit të vendit. Këtu i bënë akademitë dhe universitetet Adil Prishtina, Qerim Gjineci, Neshat Hysi, Orhan Frashëri, Ramiz Alia, Kadri Hoxha, Gjin Marku Bilo Bregu, Myqerem Fuga, Adil Çarçani, Myzafer Trebeshina, Izet Hysi, Qazim Kapisyzi, Musa Hysi, Sulo Gradeci, Vala Frashëri, Foto Çami, Njazi Braçe... Gratë ishin një forcë tjetër që barazoheshin me burrat në luftë, edhe pse ballistët i këshillonin që të merrnin me vete edhe maternitetet. Ato ishin radhitur krahe vëllezërve të tyre, që të shporrnin pushtuesit dhe mbështetësit e tyre.

Veprimtaria e Brigadës së 7-të Sulmuese nuk mund të përmbledhet në një shkrim përkujtimor, por u përpoqëm të japim detaje nga ato luftime e beteja që nuk kanë të numëruar, por deri tani janë publikuar 120 beteja dhe 3200 kilometra marshime.

REAGIMI

# OBVL, organizata e parë dhe e vetme e veteranëve pas përmbyesjes së sistemit diktatorial EDHE NJËHERË MBI TË VËRTETËN E ORGANIZIMIT TË VETERANËVE TË LANÇ

• Gjashtëdhjetëkatër firmëtarët e krijimit të OBVL, ish komandantë e komisarë, gjeneralë Heronj të Popullit, pjesmarrës në Luftën, Nc. Çl, me Platformën e shpalljes së saj me datën 27 Korrik 1994, publikuan THIRRJEN PËR BASHKIMIN E TË GJITHË VETERANVE NË NJË ORGANIZATË TË VETME

**Kolonel Trifon LLUPO**  
Nënkryetar i OBVL



Në shkrimin e botuar në Fletushkën "Kushtrim Brezash"(Përçarje brezash), nga nënkryetari i Komitetit Kombëtar të OVP të LANÇ të Popullit Shqiptar, Vladimir Marashi, veç të tjerash ka shpifje monstruoze edhe për OBVL, e krijuar para 30 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralë dhe luftëtarë, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist.

Në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane e ministra, siç ishin: Dr.Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçami, Maqo Çomo, gjeneralët: Nexhip Vinçani, Sadik Bekteshi, Muhamet Prođani, Skënder Malindi dhe Ernest Jakova; luftëtarë e shquara, drejtues në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi(Ashiku), Liri Belishova,Vera Ngjela (Pojani) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Kuvendi i parë themelues i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL) në krye të saj zgjodhi personalitetin e shquar Dr. Ymer Dishnicën dhe për afro dy dekada është drejtuar nga gjeneralëjtënant Rrahman Parllaku, Hero i Popullit e "Nderi i Kombit" dhe aktualisht drejtohet me vizion bashkëkohor e përkushtim të rrallë, nga e bija e tij, Prof. Tatjana Parllaku - Çarkaxhiu.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të veteranëve. Me pjesëmarrjen në aktivitetet e këtyre federatave, jo vetëm në Europë, por edhe në Maljazi, në Johannesburg, Marok etj, OBVL ka bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II Botërore dhe të luftave për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që jep sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s.

**FRYMA PËRÇARËSE E KOMITETIT TË LANÇ-IT**

Fryma e këtij shkrimi në fakt është jo për të mbrojtur traditat patriotike të popullit shqiptar në Luftat për Pavarësi e Liri, ku një ndër këto lufta ishte edhe Lufta Nacional Çlirimtare e Popullit Shqiptar 7 Prill 1939 - 28 Nëntor 1944, por për rikthimin e figurës më kriminale në Historinë e Kombit Shqiptar. Dhe nuk ka si spjegohet ndryshe dhe këtë e tregon dhe e vërteton civija e shokut Vladimir Marashi, i cili si meritë na paska kryerjen e Shkollës Partisë Vladimir Iliç Lenin, shkolla që përgatiste "besnikët" e mbrojtjes së vijës politike përçarëse të Popullit shqiptar dhe jo bashkimin e tij vëllazëror me njeri tjetrin, luftë të cilën e filloi që gjatë viteve të L. Nc.Çl.

Këtë nuk mund ta mohojë askush prej atyre brezave që jetaun nën atë periudhë diktatorile, gjoja të proletaritit, e cila na ishte Demokracia e vërtetë, sepse vriste e shtypte cilindo që ishte kundër dëshirës së diktatorit, pra vriste siç vrau të gjithë komandant e komisarët e njëjësive e reparteve partizane, heronjtë e popullit që i kishte shpallur vet HERONJË, gjithë drejtuesit më të lartë të Byrosë

tij Politike, deri edhe kryeministrin që ndërtoi gjithë veprat e parashikuara në të gjithë planet pesëvjeçare ndërsa Enveri vetëm priste shiritat e inagurimeve, pra nuk kishte asnjë meritë ashtu siç nuk ka asnjë meritë për drejtimin e operacioneve luftarake, pasi ato u drejtuan nga ata Komandant Korparamtash, Divizionesh, Brigadash e Batalionesh, të cilët pas çlirim-it i pushkatoj, burgosi dhe i internoi me fare-fis, në kampet e tmerrshme të asaj diktature proletariati.

Besoj se nuk është nevoja ti rreshtojmë gjith emrat e atyre Gjeneralëve dhe Heronjëve të Popullit, të Komandantëve, Komisarëve që drejtuan Luftën Nc. Çl, ku kulmin e kimit në emër të Parimit të Luftës Klasave, ky kriminel e zbatoi deri para se të nbyllte sytë, duke pushkatuar Heronjtë e fundit të popullit Mehmet Shehun, Beqir Ballokun, Kadri Hazbiun, Petrit Domen, Hito Çakon, Rrahman Parllakun, të cilit ia fali jetën, por e dënoi me 25 vjet burg. Për këto akte makabre të kryera nga diktatori e Socialisti Utopik Enver, i cili donte të ndërtonte Komunizmin në një Vend të Rrethuar nga të katër anët, nga shtete armike përpiqet të ringjallë ky pionier i Enverit i shkollës famëkeqe të Partisë Punës Shqipërisë, që e drejtoi me dorë të hekurit Enveri sepse kush e lexon këtë shkrim nuk ka sesi të mos shikojë këtë frymë marksiste leniniste, që propagandonte në çdo fjalim "Pronari" ideologjik i Shkollës Partisë. Kjo thirrje që i bën ky ushtar prodhim i shkollës partisë së Enverit të vdekur edhe ideologjikisht e jo vetëm fizikisht është një shkrim që bën thirrje për Forcimin e Parimit të Luftës Klasave, këtij Parimi më vrasës dhe më të egër që zbatoi diktatori populist dhe njëkohsisht Socialisti Utopik Enver Hoxha, ky Sen Simon dhe Furie i viteve 90-të. Në këtë shkrim autori rrëket ti bëjë një rezyme arritjes së Komitetit të LANÇ-it në të gjithë vendin, por në asnjë rresht apo fjalë nuk tregon se në çfarë varfërie është ky popull dhe këta veteran, por i ngop me lugën bosh dhe bën thirrje për një farë konference që paskan vendosur të shtrojnë detyra për ndërtimin e socializmit dhe ma pas të komunizmit sepse këtë ja detyron DATA 27 Korrik 1957 e Formimit të kësaj organizate të jshhtëligjëshme sepse ky pionieri i Enverit bashkë me pionierët e tjerë nuk e njohin Kushtetutën e Republikës Shqipërisë pasi njohin Kushtetutën Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, me Neni 55, megjithse të drejtat i kanë marrë me Ligjin për



Statusin e Veteranit të Luftës Nr, 7874 datë 17. 11. 1994, i ndryshuar ( më 1999, 2000, 2006, 2007 dhe 2019), i miratuar nga Kuvendi Pluralist dhe i shpallur nga Presidenti Prof. Doc. Berisha.

**OBVLP, ORGANIZATA E VETME E KRIJUAR SIPAS LEGJILACIONIT NË FUQI**

Mbështetur në këtë Ligj pluralist pas përmbyesjes së sistemit diktatorial, organizata e parë dhe e vetme e veteranëve është Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it, që mbron traditat dhe vlerat e gjithë Luftave të Popullit Shqiptar për Liri e Pavarësi dhe në mënyrë të veçantë Luftën Nacional Çlirimtare të Popullit shqiptar të udhëhequr e drejtuar nga ata heronjë, komandant e komisar e partizan, që i vrau e burgosi diktatori Hoxha deri sa mbylli sytë. I lutem artikull shkruarit të na sjellë një fakt të vetëm, që na bind se cili krim i diktatorit nuk qendron e nuk është i vërtetë nga këto krime të kryera nga diktatori, ku ende 6000 personave të pushkatuar e dënuar nuk u janë gjetur eshtrat dhe nuk kanë një varr, ku familjarët të ndezin një qiri. Pra këtë diktator ju e mbani mbi kokat tuaja në Zyrën e LANÇ-it dhe me propagandën tuaj enveriste, duke shfrytëzuar shpirtin patriotik të veteranëve arrini ti mashtroni me emrin famoz "Komiteti Kombëtar", kur ky komitet nuk ka si të jetë Kombëtar sepse Kombi është i shtrirë në 5 shtete në gadishullin tonë ILIRIK dhe jo Ballkan si dhe në gjithë Planetin Tokë, por nuk keni shumë fajë ju, se ka edhe emra të tjerë famoz që nuk kanë asnjë ndikim e detyr në lidhje me Kombin siç janë emrat Byroja Kombëtare e Hetimit, apo Agjencia Kombëtare filan e filanë, që janë të panurmëta, dhe vepronë vetëm brenda 28 mijë km katrorë të Shqipërisë.

Ju do të bënit gjenë më të mirë që datën 28 mars, të pranoni e të mbani Konferencën e krijimit dhe të bashkimit me Organizatën Bashkuar të Veteranëve të Luftës, siç ju kanë bërë Thirrje 64 firmëtarët, ish komandantë e komisarë, gjenerale heronjë të popullit, pjesmarrës në Luftën, Nc. Çl., me Platformën shpalljes së formimit të Organizatës Bashkuar të Veteranëve LANÇ-it me datën 27 Korrik 1994, me THIRRJEN PËR BASHKIMIN E TË GJITHË VETERANVE NË NJË ORGANIZATË TË VETME.

Kjo Platformë përbëhet nga 10 pika që, në çdo pikë të saj vlerëson e

mbron Luftën Nc. Çl. si një nga Luftat e Lavdishme të Popullit Shqiptar dhe deklaroi në pikën 5 se:

- "OBVL është organizatë patriotike pluraliste dhe e pavarur nga asnjë politike. Ne nuk pranojmë që të jemi krahu apo shtylla e ndonjë partie politike, por do të punojmë që të jemi krah dhe shtyllë i shtetit dhe i Kombit shqiptar".

- E më tej Platforma vazhdon me pika të tjera, ku në pikën 6, deklarohet :

- "OBVL dënon vendosmërisht të gjitha ato forca politike, që kanë bashkëpunuar me okupatorët nazifashistë dh e që kanë bërë krime kundër popullit, që kanë punuar kundër lirisë dhe pavarësisë së Atdheut, Ndaj tyre do të mbahet qëndrimi që meritojnë, qëndrimi që i vlen historisë dhe patriotizmit kombëtar".

-Dhe më tej me pikën 7 deklarata vazhdon:

- "OBVL, duke mbrojtur idealet e larta patriotike dhe demokratike si dhe arritjet e mëdha të LANÇ, ne dënojmë veprimtarinë përçarëse dhe diktatoriale të Enver Hoxhës dhe klikës së tij, që tradhëtuan idealet e LANÇ dhe dëmtuan rëndë shtetin dhe kombin tonë".

I vendosa këto 3 pika të Deklaratës së shpalljes krijimit të Organizatës Bashkuar të Veteranëve, të shpallur më 27 korrik 1994, dhe e miratuar me Urdherin nr 7/1 të ish ministrit të Drejtësisë Kudreta Çela, për të ritheksuar e sqarur se kush është OBVL dhe kush është Komiteti Kombëtar i LANÇ-it, që është inekzistent me Kushtetutën e Shqipërisë, pasi ky komitet me idiotizmin e tij na krenohet se na qenka formuar më 20 korrik 1957, me Vendim të Byrosë Politike, të firmosur nga diktatori Hoxha, kur ai sistem diktatorial ka vdekur me Enverin dhe duhet ta mësoj shoku Vladimir MARASHI se nuk do të ishte shkatërrim bashkimi i veteranëve në një organizatë të vetme siç e kanë kërkuar 64 firmëtarët, ku ende disa janë në jetë siç mund të prezantojmë ish Nënkryetarin e parë të OBVL, ish presidentin zotin Alfred Moisiu.

**KOMITETI I VETERANËVE TË LANÇ, MBROJTËS I DIKTATURËS ENVERIANE**

Me keqardhje të madhe kostatojmë se u ka mbetur ora ke Enveri, figurën e të cilit e mbani mbi kokat tuaja në Zyrë, por kur përkujtoni data historike të LANÇ-it e kur vendosni kurorën tek Nëna Shqipëri ose te Ushtari Panjohur nuk vendosni portretin e Enverit sepse nuk do u linte Policia e Shtetit e Republikës Shqipërisë, sepse është në shkelje të Kushtetutës Republikës Shqipërisë. Nëse nuk është e vërtetë kjo shkelje ligjore provojeni nëse jeni aq trima sa të dilni mbi Kushtetutën e Shqipërisë, që edhe Nderin e Kombit e keni marrë duke mashtruar Presidentin, sepse më parë keni mashtruar Gjykatën e Tiranës, pasi ajo Gjykatë nuk mund të pranonte t'u rregjistronte me datën 20 Korrik 1957, sepse ishte përmbytur ajo diktaturë e Hoxhës dhe duhet të mbajnë prgjegjësi ligjore kush e ka firmosur Kërkesën drejtuar Gjykatës për rregjistrimin sipas kërkesave të ligjit.

Këtu ka vend për ta shqyrtuar Gjykata Kushtetuese ligjshmërinë tuaj të datës 20 Korrik 1957 sepse sipas logjikës së çmendur tuaj duhet të

## ANALIZA

Mbi librin e akademikut Mark Zadeja “Forca e filozofisë dhe e vërteta e shpirtit”

# DOMOSDOSHMEËRIA E MENDIMIT FILOZOFIK NË KOHËN E KRIZËS MORALE

“Filozofia është logjika e zakonshme e veshur me rroba të mira”

## SHPENDI TOPOLLAJ

**B**ariu i dikurshëm i kopeve të deleve nga fisi Banu Hothail dhe më pas besniku i profetit Muhamed, Abdullah ibën Mesudi, duke folur për nevojën e mendimeve të dijetarëve në zhvillimin e shoqërisë, ka thënë një herë se: “Jetojmë në kohën ku ekzistojnë shumë dijetarë, por ata që flasin janë të paktë. E do të vijë koha kur do të ekzistojnë pak dijetarë, e ata që do të flasin do të jenë të shumtë”. Dhe ndofta ajo kohë tani ka ardhur, pasi të ditur, dua të them filozofë ka pak, kurse ata që nuk pushojnë duke broçkullisur nga mëngjesi deri në darkë kotësira pa bereqet, janë të pafund. Kjo është edhe arsyeja, pse pak a shumë, mendimi i përparuar ka ngelur në vend. Filozofët tani thuajse nuk i përfill askush, deri dhe pushtetarët, kështu që detyrohen të heshtin, duke harruar atë që artikulonin Platonin se “Vendet më të nxehta në Ferr janë të rezervuara për ata që ruajnë neutralitetin e tyre në momente të një krize të madhe morale”. Shqipëria jonë e dalë me humbje nga imponimi i filozofisë marksiste - leniniste, në kushtet e demokracisë, natyrisht që e kishte të domosdoshme, një përjasje të re filozofike, por e gjendur para të panjohurës, shoqëria pësoi atë që rëndom e quajmë “krizë morale”. Rrjedhojat e kësaj krize, pas boshllëkut të krijuar, ne i ndeshim shumë shpesh dhe në shumë drejtime, deri edhe në sjelljen e të rinjve në jetën e përditëshme. Dhe si për të mbushur sado pak këtë boshllëk, akademikun shumëplanësh shkoderan Mark Zadeja, na vë në duar librin e tij “Forca e Filozofisë dhe e vërteta e Shpirtit”. Ai nuk e ndan në asnjë nga librat e tij ndikimin e filozofisë mbi shpirtin e njeriut, se tek e fundit vetëm kështu teoria mund të shndërrohet në forcë veprimi, në shpërthim energjisht për të arritur së pari, pra si kushtin themelor, fitimin e lirisë që neve aq shumë na ka munguar. Ja si shprehet vetë ky autor plot pasione dhe që mendimin e tij filozofik e sheh si vazhdimësi, si derivat të trashëgimisë së filozofisë botërore ndër shekuj: “Dituria, në garantimin absolut të saj, nuk rrezikon asgjë, duke forcuar strukturën e shpirtit, dhe nëse e strukturon atë me vlera të paçmueme, ajo qëndron e pamposhtur, është e aftë, garantuese; dhe kompetencat e filozofisë bazohen, qëndrojnë më të forta duke i dhënë asaj (strukturës), vlera të larta që nuk kanë çmim”. Dhe ndofta më bukur, ai e shpreh këtë në vargje si te poezia “Lindja e Lirisë”: “Heshtje deri në vëllje... / Askush nuk dyshoi / Sepse mungonte thënia, shkrimi. / Ajër, shpirt, akordim shkronjash... / Qiriu u ndez, tingëllim i heshtjes. / Profili im - imazh penelash,, / Lindja e Lirisë...”. Oliver Braston, ashtu si me gjysmë shakaje ka thënë një të vërtetë të madhe: “Filozofia është logjika e zakonshme e veshur me rroba të mira”. Por, ja që pikërisht kjo ia rrit vlerat vetë filozofit, se ec e merre masën, prijë saktë dhe qepe me shije kostumin e vetëm që kushdo që ta veshë, t’i rrijë sa më mirë dhe të mos ankohet. E ja pra, këtë bën edhe Marku, pas studimeve, udhëtimeve, përvojave, takimeve dhe kulturave të ndryshme ndër vite. Këtë e konstatojnë edhe recenzentët e librit Anelore Euler dhe Albert Gjoka kur thonë: “Ky djalosh i përjetësisë së shkrimit të filozofisë dhe mendimit të saj, me pasionin e një poeti na tregon se nga shoqëritë dhe bota e tërë kemi shumë për të mësuar, dhe akoma më tepër me sinjoritë të tij se mishërimi me mirësinë do na drejtojnë drejt pasioneve të sinqerta dhe zbulimit të vetvetes me pashtershmërinë e shpirtit ngadhënjimtar...” Edhe më parë, sidomos nëpërmjet sentencave dhe afor-



izmave, Marku i ka shpërfaqur konceptimet e tij për gjithçka jeta dhe veprimtaria e njeriut përmbledh, por në këtë libër, ai ndalet edhe tek ajo që shoqëria ndër breza ka trashëguar nga Heronjt e mendimit, duke filluar qysh nga ata të lashtësisë, por që mbetën deri më sot aktualë. Ja pse Marku shprehet se gjithçka doli nga mendja e pionierëve të parë të intelektualit, pra Platonit dhe Aristotelit, jo vetëm që nuk mund të përçmohen nga askush, por ato mbetën pika referimi për të gjithë studiuesit, dijetarët dhe qytetërimet e mëvonshme në përgjithësi. Ky autor na sjell në vëmendje gjithashtu veprën e ndritur të Sokratit, Demostenit, Herodotit, Aristofanit, Tukididit, Sofokliut, Ksenofonit, Heraklitit, Pitagorës, Pindarit apo oratorëve si Alcidas dhe Antifoni etj. deri tek ata të mëvonshmit si Njutoni, Hobsi, Descartesi, Leibnizi, Spinoza, Locke, Hume, Kierkegardi, Lichtenbergu, Kanti, Husserli etj. Natyrisht që ai merret me momentet kryesore të jetës apo asaj që ata krijuan dhe sidomos me atë pjesë që lidhet drejtpërdrejtë me gjithë sa ngjet në mjedisin tonë sot që pretendohet se kemi ndërtuar shtetin demokratik të të drejtës dhe lirisë, por që ende jemi larg saj. Kështu, duke mbetur vetëm te “Republika” e Platonit (edhe pjesa e doktrinës së përmirësuar), Marku arrin në përfundimin se “Nga kjo rrjedh se njeriu që njeh filozofin ose dijetarin o një shkencëtar duhet të ketë fuqi vendimtare në qeverisje, të cilën vetë kjo njohuri i jep të drejtën”. Po pse ndodh që sot, sikur nuk u kushtohet rëndësia e duhur mësimëve të këtyre burrave të mençur? Përgjigjja është fare e thjeshtë: për të pushtetshmin, më mirë të mbajë pranë një të paditur, e për rrjedhojë, të pa dinjitet e të bindur deri në nënshtrim, se sa një që mund të ketë mendimin se intelektual i vërtetë është ai që zbaton ato që mëson te Emmanuel Kanti i cili nga ana e tij, sipas Markut “ishte një mendimtar i ndritur, kampion i lirisë së shprehjes dhe i rolit të kritikës ndaj fuqive absolute që dominonin botën e kohës së tij, (që) nuk pushoi kurrë së propozuari zgjidhje për përmirësimin e bashkëjetesës”. Por shtetarët si Frederiku i II - të i

mbiquajtur i Madhi apo si ministri i tij i Fesë dhe Arsimit Abraham Zedlitz, mbështetësa të vendosur të domosdoshmërisë së filozofisë, fatkeqsisht janë të rrallë, për të mos thënë se në Shqipëri, ata mungojnë fare. Dhe Mark Zadeja nga ana e tij, duke mos e ndarë ndikimin e filozofisë me ripërtëritjen e shpirtit njerëzor, të cilën e quan përcaktuese të Mirësisë, si një domosdoshmëri e pashmangshme e së Vërtetës, ka mendimin themelor se “Duke përshkruar rrugën me shpirtin tim, sigurisht për të qartësuar mendimin e shprehur, ndoshta edhe për të plotësuar temën qendrore të kuptimit, e shoh të nevojshme të sqaroj për bashkatdhetarët e vuajtur, objektivisht, realitetin e njohur prej të gjithëve. Duke pasur tashmë në liri guximin, i vendosur, me bindje për lirinë. Duke u bazuar me bindje te besimi, jam plotësisht i sigurt se DITURIA e popullit tim në shekuj me njerëzit e ditur që kanë dalë prej gjirit të tij, qëndron edhe pasuria e mendjeve të ndritura të këtij populli”. Dhe patjetër që dituria është si për çdo popull edhe për ne, pasuria më e madhe e cila ka qënë dhe mbetet garancia e përparimit. Por për ta bërë realitet këtë të vërtetë jetike, duhet që intelektualët së pari të mos presin Ferrin metaforik duke qëndruar neutralë në këto momente të krizës morale që shoqëria jonë po kalon. T’at thonë fjalën e tyre të mençur me guxim e kulturë, ashtu sikurse bën edhe miku ynë i virtytshëm, shkoderani atdhetar Mark Zadeja i cili te një poezi shoqëruese të këtij libri na “Premton”: Mendimi randon, / Rrëzohet, po s’flet. / Nata përsërit... Andrrim... / Rikujtesa e ndjenjës ndriçon dritën e hanës, / Belbëz, shpërndan mjegullën e natës që shkoi, / Premton, thërret fatin, merr përsipër / Besimin drejt Qiellit”. Ndofta kjo e ka nxitur edhe shenjtorin e shpallur qysh në vitin 1461 nga Papa Piusi i II - të, Katerinën e Siënës, e njohur për letrat me këshilla që u dërgonte hierarkëve të lartë të Kishës, që të thotë: “Rruga për në parajsë kalon nëpër qiell, dhe e gjithë rruga për parajsë është parajsë”. Ja pse nuk na mbetet tjetër, veçse t’i urojmë mikut tonë filozof, mbarësi në këtë udhëtim drejt “parajsës”!

## IN MEMORIAM

25-vjet nga ekzekutimi i akademikut të shquar kosovar nga forcat shoviniste serbe

## FEHMI AGANI - DIJETARI I SHQUAR QË LUAJTI ROL KYÇ NË PROCESIN POLITIK DHE INTELEKTUAL TË KOSOVËS

Nga Bashkim Hisari

Fehmi Agani ishte një intelektual, politikan dhe sociolog i shquar shqiptar nga Kosova. Ai luajti një rol të rëndësishëm në lëvizjen për pavarësinë e Kosovës gjatë viteve 1980 dhe 1990. Agani ishte një ndër themeluesit kryesorë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), partisë së parë politike pluraliste në Kosovë, dhe një bashkëpunëtor i ngushtë i Ibrahim Rugovës. Ai dha kontribut të madh në zhvillimin e mendimit sociologjik shqiptar dhe punoi si profesor në Universitetin e Prishtinës. Agani shkroi shumë libra dhe artikuj shkencorë për tema si shoqëria, identiteti kombëtar dhe raportet ndëretnike. Kosovën e shihte si pjesë e natyrshme të Evropës dhe argumentonte për nevojën e një angazhimi më të madh me perëndimin.

Gjatë viteve 1998-1990, kur Kosova po përballlej me represionin e regjimit serb, Fehmi Agani ishte një prej figurave kryesore të lëvizjes politike shqiptare i cili mbështeste dialogun dhe zgjidhjen politike të çështjes së Kosovës. Aktivisht u angazhuat në procesin e dialogut dhe diplomacisë për zgjidhje politike të çështjes së Kosovës. Mori pjesë në negociatat dhe dialogun me faktorin ndërkombëtar për të gjetur një zgjidhje paqësore. Ai ishte një nga antarët kryesorë në delegacionin kosovar në Rambuje në vitin 1999 ku u diskutua e ardhmja e Kosovës. Pranimi i marrëveshjes në Rambuje rezultoi me



Shtatorja e Akademik Fehmi Aganit



Presidenti Ibrahim Rugova Akademik Fehmi Agani

që të tërheqet nga Kosova, të pranojë marrëveshjen e Kumanovës dhe pastaj edhe me çlirim të vendit, përfundimin e luftës dhe pavarësinë e Kosovës.

Fehmi Agani u vra më 6 maj 1999 gjatë luftës në Kosovë. Vetëm disa javë para se Kosova të çlirohet përfundimisht nga Serbia. U ekzekutua barbarisht nga forcat serbe që kryenin spastrim etnik ndaj shqiptarëve.

Me rastin e 25-vjetorit të ekzekutimit të Fehmi Aganit, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës organizoi tryezën shkencore me temën: Akademik Fehmi Agani-figurë shumëdimensionale e shekullit XX. Historiani dhe akademik i shquar shqiptar, Jusuf Bajraktari, i cili ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në historiografinë shqiptare përmes studimeve, botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore, që ishte student i dikurshëm dhe bashkëpunëtor i ngushtë i profesor Aganit, për gazetën "Veterani" thotë: "Në plejadën e dijetarëve të shquar, me emrin e të cilëve është i lidhur ngushtë zhvillimi i gjithëmbarshtëm i periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, padyshim spikat figura e Akademik Fehmi Aganit. Ai zë vend të dalluar në pijadestalen e kësaj plejade e të të merituarëve. Ishte simbol i një intelektual të afirmuar në suaza kombëtare dhe ndërkombëtare nga i cili priste jo vetëm populli i Kosovës por edhe opinioni liridashës e demokra-

tik evropian, Akademik Fehmi Agani e përmbushi katërciprisht detyrën e tij prej patrioti dhe e mbylli jetën me nderë e admirim prej një misionari të devotshëm në shërbim të Lirisë dhe të Pavarësisë së Kosovës" thekson Akademik Jusuf Bajraktari.

Fehmi Agani lindi në Gjakovë më 23 janar 1932, në një kohë kur varfëria dhe terrori serb mbi popullin shqiptar kishin bërë kërdi. Ai vinte nga një familje patriotike, nga Plava e cila si pasojë e dhunës dhe gjenocidit militarist serb, ka qenë e detyruar ta lëshonte disa herë vatrën familjare e të bëjë jetë jabanxhiu në tokën e vetë. Njëri nga paraardhësit e tij të shquar, Mulla Agani ishte vranë e masakruar nga serbët si pjestarë i "Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës". Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Akademik Agani qysh në moshën e re, u rreshtua në anën e LNÇ-së dhe të Aleancës Antifashiste të cilat i vlersonte, në aspektin teorik e shkencor.

Fehmi Agani shkollën fillore e mbaroi në Gjakovë, ndërsa të mesmen e kreu në Prishtinë. Studimet për filozofi i mbaroi në Universitetin e Beogradit. Studimet Pasuniversitare në Shkencat Politike i mbaroi poashtu në Universitetin e Beogradit,

Gradën Doktor i shkencave të sociologjisë e mori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës më 1973 me tezën "Partitë dhe Grupet

Politike në Shqipëri". Më 1993 u zgjodh anëtar korrespondent, ndërsa më 1996 anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Akademik Agani, në 10 vitet e fundit të shekullit XX ishte njeriu më aktiv në lëvizjen e Përgjithshme për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës. Me formimin e LDK-së si partia e parë me orientim demokratik perëndimor Fehmi, Agani u zgjodh nënkryetar i kësaj partie politike, si njëri ndër kryesorët dhe më të merituarit për hartimin e dokumenteve të rëndësishme në rrugëtimin politik të Kosovës. Ai ishte dora e djathtë e Presidentit Historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, i cili duke kujtuar shembëlltyren e Profesor Agani do të shkruante: "Kosova krenohet me Profesor Aganin, veprën dhe figurën e tij. Profesor Agani ishte një burrë i madh i Kosovës, një njeri me mendje dhe zemër të madhe, siç e njohim ne, si dhe siç e dinë të gjithë miqtë tanë, ishte dhe do të mbetet përjetësisht Heroi i Kosovës dhe figura më markante e vendit". Akademik Jusuf Bajraktari shton se këto tipare të personalitetit të veçantë ndikuan që Profesor Agani, në planin e brendshëm të "gëzonte simpatinë dhe adhurimin e studentëve dhe qytetarëve të Kosovës, duke qenë shembulli i maturisë politike dhe këmbnguljes për veprim të përbashkët për sendërtimin e rrugës së lirisë. Ai, padyshim, ishte njeriu më i shquar për bashkimin e asjeve divergjente në skenën tonë politike prandaj gëzonte autoritet të pakontestueshëm si në mesin e bashkëpuntorëve të tij edhe në mesin e atyre që nuk pajtoheshin me të".

Kujtimi dhe respekti i qytetarëve të Kosovës, veçmas të ish studentëve të Profesorit Fehmi Agani. është jo thjeshtë një simbolikë kohe por është mesazh për opinionin kosovar që në këto kohë të antagonizmave dhe polarizimeve të thella të shoqërinë kosovare, të rigjejnë modelin e traditës aganiane në kapërcimin e pengesave drejtë synimeve të vlerave madhore për forcimin, zhvillimin e Republikës së Kosovës.

Akademik Fehmi Agani, për meritat dhe kontributet e tij intelektuale dhe politike ishte bartës i shumë dekoratave. Ai mbetet një figurë e respektuar në historinë e Kosovës për vizionin e tij intelektual dhe angazhimin e tij të palodhur për liri dhe drejtësi.



Akademik Jusuf Bajraktari

ndërhyrjen ajrore të NATO-së, kundër forcave serbe, me pranimin e Serbisë

## EDHE NJËHERË MBI TË VËRTETËN E ORGANIZIMIT TË VETERANËVE TË LANÇ

(Vijon nga fqaja 3)

rikthehen levat e tjera të PPSH-ës, Organizata e Frontit Demokratik, Organizata e Bashkimit Grave të Shqipërisë, Bashkimi Rinisë Punës Shqipërisë, Bashkimet Profesionale etj.

Ky Marashi pionier i shkollës partisë së Enverit a nuk e kupton se sa antidialektik është, kur shkruan se :

- Me OBVL-ën nuk na ka lidhur e nuk na lidh asgjë, përderisa krerët e tyre se antarësi nuk kanë janë kundër të vërtetave më të mëdha të historisë së LANÇ. Vetëm nëse deklarojnë hapur në media të ndryshme dhe në dokumentet e tyre gabimet e rënda që kanë kryer deri tani dhe kur të pranojnë Statutin dhe Programin e Organizatës tonë, do të mund arrihet unifikimi që pretendojnë, unifikimi i arritur jo si bashkim krerësh nga lart, por si

një bashkim që do të fillonte nga kontributi i dhënë në bazë.

Po, është e vërtetë se nuk jeni lidhur, me gjithë Ftesën e bërë nga 64 firmëtarët e Grupit Nismëtar të OBVL, që ua spjegova më lart, si organizatë e vetme e ligjshme që ishte OBVL dhe për dijeni tuajën dhe Komitetin tuaj, kur janë zhvilluar mbledhjet në qarqe për krijimin e OBVL-ës kanë marrë pjesë gjithë veteranët pa dallim, ju u gjalluat pas rrebelimit të 1997-ës, pra u ndatë ju nga OBVL. Këtë e vërtetojnë dokumentet e veteranëve që janë me qindra në arshivën e OBVL-ës me fotografi, mund të vini e ti shikoni me sytë tuaj. Për arsye etike ndaj fëmijëve të tyre ne nuk i kemi afishuar në faqet e shtypit.

Ju jeni organizatë e jashtë ligjshme, sepse nuk keni bërë ndonjë Konferencë për krijimin e Organiza-

tës tuaj të Veteranëve, me vendosjen e sistemit pluralist demokratik, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por jeni vazhduesja e asaj organizate, e cila i ka djegur pëllëmbët e duarëve duke miratuar pushkatimin dhe burgosjen e gjithë Komandantëve, Komisarëve të Korparmatave, Divizioneve, Brigadave e Batalioneve që çliruan Shqipërinë, heronjë të popullit dhe gjeneral.

Ju thoni e mburreni se jeni Nderi Kombit, por në fakt ky popull në 1990-ën, ju shpalli Turpi i Kombit, duke e rrëzuar bustin e komandantit tuaj, duke ia hequr të gjitha meritat e dekortat realisht, për krimet që i kishte bërë këtij populli deri sa mbylli sytë.

Prandaj ai Statut e ai Programi juaj është i jashtë ligjshëm sepse mban datën 20 KORRIK 1957.

## PROFILI

*Kushtuar dëshmorit lab nga Fushëbardha e krahinës së Kardhiqit*

# XHEZO PRODA DËSHMOR I ATDHEUT, KRENARI E KOMBIT SHQIPTAR

• *Xhezo Dervish Proda (20.9.1926 - 10.9.1944), dëshmor i gjithë kombit shqiptar. Partizani 18 vjeçar, i Brigadës së Gjashtë Sulmuese që sfidoi moshën, mentalitetin dhe kohën, luftoi dhe marrshoi me këmbë për dhjetra beteja çlirimtare. Ishte pjesë e Br. VI S që për 679 ditë u shqua për trimri në luftë dhe fitore ndaj fashizmit. Nga Fushëbardha si pjesë e formacionit luftarak të Br. VI S kanë derdhur gjakun për atdhe dhe mbajnë sot titullin e madh “dëshmorë”: Latife Veli Nora, Alem Zano Shehu, Tahir Reis Xhuvani, Kutbi Çelo Gjeçi, Muin Myslim Balashi (nga Mashkullora, por lindur në Fushëbardhë) dhe ishte djali i hoxhës së fshatit) dhe Xhezo Dervish Proda patizani që luftoi dy vjet në formacionet antifashiste shqiptare. Janë emra të gdhendur në historinë e LANÇ-it dhe historinë kombëtare, janë meteorë në qiejt e lirisë*

**Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI**

## I LINDUR NË PREHËRIN E TRADITËS LUFTARAKE, DJEPIN E MENÇURISË LABE

Xhezo Proda i lindur në prehërin e traditës luftarake dhe djepin e mençurisë labe Në djepin e mençurisë dhe trimërisë mes maleve labe është lindur 98 vite më parë Xhezo Dervish Proda. Ai erdhi në jetë në vjeshtën e parë (20 shtator, ditën e hënë) të vitit 1926, në vatrën e Prode në lagjen e Onjere në Fushëbardhë. Xhezo Proda rridhte nga një familje fushëbardhase me tradita luftarake, patriotike e atdhetare. Nga fisi dhe trangu familjar i Xhezos në vijimësi kishin luftuar me pushtuesit sa herë binte kushtrimi i luftës. Ato pak klasë fillore i mori në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Çizmjia e rëndë e pushtimit kishte pllakosur si në çdo fshat të Labërisë, edhe në vendlindjen e tij, Fushëbardhën. Mjedisi familjar megjithë hallet e kohës ishte një unitet brezash, unitet familjar dhe të përbashkuar me bashkëfshatarët e bashkëkrahinorët e dy krahinave të Kardhiqit dhe të Rrëzomës nëpër shekuj në lufrat për liri, pavarësi dhe çlirim nga pushtuesit osmanë, grekë, italianë, austrohungarezë e deri nazifashistët gjermanë.

Në trugun familjar të oxhakut “Proda” janë të njohur në Fushëbardhë Kapo Proda me katër djemtë Ismaili, Dervishi, Fetani dhe Shemsiu. Kapua ishte martuar me Hatemen nga fisi Logli i Zhulatit. Ismaili ishte martuar me Hazbije (Bije) Baze nga Peshtani i Tepelenës dhe kishin katër fëmijë dy djem dhe dy vajza: Aliun, Kasëmin, Sheko, Safife, si dhe Hazbon (me gruan e parë).

Dervishi (Xhako i flisnin) ka qenë martuar me Zejnebi Bijo/Proda me të cilën lindën katër djem e dy vajza: Xhezo, Afife, Babuden, Siadete, Ulsi dhe Vehipi. Fetani martuar me Aleme Muçaj/Proda nga Vergoi; lindën dy djem Sherifin dhe Kapo si dhe tri vajza: Gaze, Haxho dhe Bezene. Shemsiu ka qenë martuar me Neko Shalari dhe patën dy djem: Tajarin, Lumanin. Pasi ndërroi jetë Nekua, Shemsiu u martua me Alemen nga Zhulati dhe lindën Xhemalin dhe Barjamin. Në rrethin më të afërt familjar të dëshmorit Xhezo Proda ishin tre vëllezërit dhe dy motrat e tij. Dervish Proda dhe Zejnebi Bijo/Proda i mëkuan bijtë e bijat e tyre me dashurinë për Atdheun dhe me etjen për liri, por edhe pasi ra në fushën e nderit biri i tyre gjithë pasardhësit mbajtën lartë idealet patriotike dhe atdhetare sikurse ishin dhe mbetën atdhetarë: Afifja që u martua me Shefqet Golemin lindën Iblo, Shpëtim, Drita, Sabihe; Babudeni me Bele Cama/Proda lindën Republika, Dervish, Telha, Xhuljeta, Trifon dhe Kristina; Siadetja dhe Dervish Biro lindën Zurhanë dhe Eli; Ulsi me Xhemo Hoxha/Proda nga Vergoi lindën Agimin, Fatmirin dhe Margaritën; Veipi me Theodorën lindën Erjonin dhe Rudinën.

Faktet vijnë nga kujtimet e nënës së dëshmorit Xhezo Proda, Zejnebisë që tregonte: “Kur lindi Veipi në shtëpinë tonë ishte gjëmë e madhe sepse 3 muaj e gjysmë më përpara ishte vrarë Xhezua në Labinot... vetëm gjyshja Hatua kujdesej për vëllanë ...Xhakua e donte për mendje të kokës...i urtë, punëtor, i zgjuar, i dashur...i pjekur para kohe, i vendosur si Xhakua (i ati) ..lufta mori djem në qemal dhe ajkën e djalërisë edhe



për Fushëbardhën e Labërisë”. Një oxhak i madh me rrënjë lisi me vlerë trashëgimie atdhetarie, që i bëjnë nder fshatit, trevës labe. Nga të gjithë fëmijët e Dervish Prodës, vetëm Xhezua “u martua” me lirinë dhe ngeli në përjetësi si meteor ndriçues e frymëzim për brezat. Kur lindi Xhezua Shqipëria jetonte “Republikën e parë”.

Xhezua i etur për dije mësoi shumë që fëmijë për vendin e sapo dalë nga një kompleksitet ngjarjesh të pavarësisë së shtetit të 1912-tës, të luftës me andartët (1913-1914), ku dha jetën edhe komandanti i çetës së Fushëbardhës në Skërficë Halil Huto Sullo/ ose Proda sepse Sullajt dhe Prodajt ishin nga një “vatër-zjarri” të një oxhaku. Xhezua mësoi edhe për Luftën e Madhe (1914-1918), ku shkeli këmba e mbi 250 mijë ushtarëve të 7 ushtrive të huaja, të ngjarjeve madhore të Kongresit të Lusnjës dhe Luftës së Vlorës të 1920-ës, ku nga çeta e Fushëbardhë me 78 jataganë/luftëtarë ishin edhe djemtë e oxhakut “Proda”, luftëtarët e fisit të Xhezos ishin babai i tij Dervish Proda, Xiflo Proda, Jupe Proda etj., për Fushëbardhën e Fushëvërrinë. Familja ku erdhi në jetë Xhezua ishte e nderuar dhe e respektuar në fshat dhe krahinë, por vlerat ja shtoi edhe më shumë gjaku i derdhur për lirinë e Shqipërisë, duke konsoliduar vijimësinë patriotike të fisit.

## LUFTËTAR LIRIE QË NË MOSHËN 16 VJEÇARE

Xhezo Proda u bë pjesë e formacioneve partizane që nga fillimi i krijimit të formacioneve partizane. Prushi i zjarrit të luftës partizane ishte ndezur pas pushtimit në të gjithë Shqipërinë. Sikurse në të gjithë vendin në fshatin e Xhezos, në Fushëbardhë më 12.12.1942, u krijua formacioni i parë partizan çeta partizane “Çerçiz Topulli” ndër të para çeta partizane në Shqipëri, kur Xhezo Proda ishte vetëm 16 vjeç.

Kujtimet e shkruara nga Resul Bedo dhe Islam Idriz Poçi janë të gjalla për Xhezon që transmetohen që kur Xhezua u aktivizua me rininë antifashiste, me çetën, batalionin partizan, kur shpërfillën vitet e pa-

kta të moshës, kur shkoi vullnetar në çetë e në batalion “Asim Zeneli, kur mori pjesë në të gjithë luftimet e batalionit, kur u shqua për trimëri dhe guxim, kur u përbashkua dhe u rreshtua me forcat e BrVISulmuese”.

Bashkëfshatarët dhe bashkëluftëtarët kanë shkruar epopenë e madhe të luftës, luftimet e përgjakshme, përbashkjen e Xhezo Prodës dhe luftëtarëve të tjerë me topat e mitralozat, me autoblindat dhe pajisjet më moderne të kohës nga ana e pushtuesve nazifashistë. Në luftën e përgjakshme të tre ditëve të Labinotit ku forcat e tre batalioneve gozhduan autokolonat armike por ndërkohë që pushtuesi la shumë të vrarë (që i ka deklaruar vetë), forcat partizane patën 11 heronj lirie, përfshi dhe djalin 18 vjeçar nga Fushëbardha Xhezo Proda. Në Labinot përfundoi aktivitetin luftarak Xhezo Proda, pjesëmarrës në katër formacione partizane, dhe në të gjitha luftimet nga Fushëbardha në Elbasan. Në luftimet e brigadës së gjashtë sulmuese në Labinot u vranë 11 partizanë meteorë lirie: Xhezo Proda, Balil Peçi, Luto Çani, Sulo Baka, Halil Halilaj, Neki Hasani, Bajram Lalaj, Riza Çani, Tefik Selaj, Jonuz Balilaj, Merdan Kalemaj dhe u plagosën 21 të tjerë. Gjurmët e 11 dëshmorëve të Labinotit zënë një vend nderi në rrugëtimin luftarak dhe historikun e brigadës së gjashtë sulmuese.

Në këtë luftë u plagos për vdekje dhe Arif Bizhga (nga Kaparjeli), që për momentin u përllorarit si “i vdekur”, por lëvizja e gishtave e shpëtoi dhe u mjekua si dhe jetoi gjatë. Arifi që ishte shok i Xhezos, ngeli invalid lufte, pasi e çuan urgjent në shtëpinë e Sami Bahollit, ku shërbente mjeku italian, Mario, i cili e pa “të vrrarin” dhe tha: “është shumë rëndë është, por do bëjmë çmos ta shpëtojmë”. Në fakt shok i armëve të Xhezos jetoi për të treguar epopenë e trimërisë së bijëve të Labërisë në betejën e Labinotit. Luftëtarët e rënë u varrosën në Labinot me një ceremoni solemne ku mori pjesë edhe populli i fshatit Labinot. Në xhepin e dëshmorit Xhezo Proda shokët i gjetën një letër që e dërgonte nëna e tij: “Bir i nënës, Xhezo. Po bëhet mjaft kohë që s’te ka parë nëna e shkretë. M’u dogj zemra jemi dit e netë në zjarr, po as unë as nënat e shokëve të tu nuk trembemi.

Bjeruni fashistëve, se na shkretuan vendin, që u shkretofshin dhe një mos mbetë..”. Për luftën e Labinotit është folur e shkruar shumë ndërsa ka shkruar edhe ish oficeri nazist gjerman në këtë luftë Herman Frank: “Aty ka më shumë humbje se sa në njësitë e angazhuara në luftë kundër çetave. Spitali në Elbasan është mbushur plot me të plagosur dhe të vrarët nëpër varreza si vijnë dhe shtohen” (Herman Frank, “Bandenkampfe in Albanien”, Heidelberg, 1957, faqe 91). Luftimet në këtë periudhë në Labinot drejtoheshin nga komandant Jaho Gjolliku dhe komisar Haki Toska. Fakt është se lufta antifashiste partizane në Fushëbardhë, në fshatin e Xhezos gjeti shtëpinë e saj të lirisë, pasi Fushëbardha u hodh masivisht në luftë për liri dhe çlirim, me mbi 120 partizanë nga të cilët 15 ranë dëshmorë të pavdekshëm të lirisë. Në Fushëbardhë gjatë luftës u krijuan Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar (10.11.1942), çeta “Çerçiz Topulli”(12.12.1942), Komanda e vendit, depot e ushqimit dhe municionit, Spitali partizan, Këshilli i Gruas An-

## ESSE

# Dëshmorë Sinan Lame Liza, trup e shpirt, për liri!

Neki ÇAKO

**H**istoria e LANÇ është e shkruar jo me penë, por me bajonetë, bajonetë të larë me gjak. Ajo është shkruar, jo në letër, por në shkëmbinj, atje ku luftëtari valen dridhte, në çdo breg, a në çdo ledh, ku era ballin j'ua fladiste e mbrëmja hapte bukuritë, atje ku kënga për Atdheun jehonte, e bridhte nëpër kodra e përrenj, atje ku fitorja nisi të buzëqeshë, ku vendi skuqej me gjak dëshmorësh!

Atje nën dritën e Hënës, shkruhej histori, me fjalë për nënën, të madhen Shqipëri! "Kombi që nuk harron bijtë e tij të rënë në luftë, nuk ka vdekje kurrë". Dëshmorët janë të pranishëm në sofrat familjare, në kuvënde popullore, në ditë me furtunë, në ditë të qeta e në festa, përherë në krahë me të gjallët, në jetë, në luftë e në punë. Dhe kudo e kurdoherë na frymëzojnë atdhedashuri, trimëri, vendosmëri, përkushtim, urtësi, fisnikëri, drejtësi, dashuri njerëzore. Jeta ka dallgët e saj, tallazet e saj. Por jeta dhe vepra e dëshmorëve kanë për tipar dallues: unitetin e kompaktësinë, vendosmërinë, atdhedashurinë, luftën për kapërcimin e vështirësive. Duke luftuar për çlirimin e vendit, ata mbillnin farën e madhe të lirisë, embrioni i së cilës rritej në zemrat e shqiptarëve atdhetarë. Dhe shembullin e jepnin vetë të parët, me jetën dhe gjakun e tyre. Në thelbin e zemrës së dëshmorëve qëndronte krenari e pamposhtur atdheu. Në sytë e bukur të tyre ishte vizatuar qielli i kaltër i lirisë, në emër të së cilës, ata ranë për të mos vdekur kurrë: Njeri nga të cilët është edhe Dëshmorë Sinan Lame Liza.

Sinani ka lindur në Nivicë të Kurveleshit në vitin 1906, në një familje të varfër fshatare. Që në moshë fare të re mbeti jetim nga ana e babait dhe u rrit nga xhaxhai i tij Nebi Liza. Rininë e tij e kaloi në fshatin e tij të lindjes. Merrej me bujqësi si e vetmja



mënyrë për të mbijetuar. Me shumë vullnet, arriti të mësojë shkrim e këndim. Më, 1925 kreu shërbimin ushtarak duke kryer detyrën e guzhinjerit, të cilën me këmbëngulje arriti ta mësojë dhe ta profeksionoi edhe më shumë aty. Pas përfundimit të ushtrisë ai do të punonte në një ndërmarrje që merrej me sipërmarrjen e rrugëve në qytetin e Burrelit. Paskëtej ai, do të shkonte të punonte në një shoqëri të huaj që merrej me kërkimin dhe nxjerrjen e arit të zi shqiptar (naftës), në katundin Vllahinë të Vlorës. Aty, njohu shfytëzimin më të egër

që u bëhej puntorëve të krahut të cilët punonin me orë të zgjatura dhe merrnin një pagë qesharake. Ai do të kuptonte se regjimi që kishte pllakosur vëndin ishte i egër. Kështu që vendosi të largohej andej duke ushqyer edhe urrejtjen për pushtuesin. Ai do të kthehej në Nivicë dhe në vitin 1942, ai do të merrte pjesë në kshillin e fshatit dhe formimin e njësitit gueril. U bë promotor i lëvizjes duke marrë pjesë në shumë aksione të ndryshme kundër pushtuesve italianë, duke e dëmtuar atë në disa sektorë të ndryshëm. Familja e tij do të kthehej në një bazë të luftës e lëvizjes. Ka qënë efektiv i çetës partizane "Avni Rustemi" e cila më vonë do të merrte emrin "Demo Fejzo" dhe do të inkuadrohej në batalionin "Asim Zeneli". Në gusht të 1943 do të rreshtohet në radhët e brigades VI duke u bërë efektiv i saj. Për të kaluar më vonë në brigadën e VIII- sulmuese. Shtëpia e tij do të digjej, e bëhej shkruar e hi, nga fashistët italianë në operacionin e prillit të vitit 1943. Sinani mori pjesë në shumë luftime, duke treguar një trimëri të pa shoq. I vendosur për kauzën e popullit për çlirimin e Atdheut, sepse gurin e vëndlindjes nuk e ndante kurrë nga mëndja. Më, 27 Gusht të vitit 1944, ra me armë në dorë, në luftë për çlirimin e Konispolit. Për meritën të veçanta, Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar me medaljen e Kujtimit, Timërisë dhe të Çlirimit. Lapidarë të lirisë ishin vetë ata, që u bënë flakadanë të përjetësuar. Lapidar lirie është dhe Sinani ynë, për të cilin kemi mall, por edhe jemi krenarë. Atë sot dhe gjithmonë, Familja Liza, fshati Nivicë, Krahina e Kurveleshit, dhe tërë Kombi Shqiptarë, e kanë dhe do ta kenë, Diell Lirie, me rreze të lira, sepse Sinani me shokë, na e sollën lirinë. Ata janë vetë liria jonë. Dhe kur flasim për atdhetarët, të parët janë dëshmorët! Lavdi jetës dhe veprës së lavdishme të dëshmorëve! Ata rrojnë dhe janë të pavdekshëm në altarin e Lirisë!

## XHEZO PRODA DËSHMOR I ATDHEUT, KRENARI E KOMBIT SHQIPTAR

(Vijon nga faqja 6)

tifashiste (17.1.1943), batalioni teritorial i krahinës së Kardhiqit, me komandant Karafil Bello. birin e krahinës të fshatit Fushëbadhrë (Cepo më 31.7.1943); batalioni "Abaz Shehu" (12.12.1943), pasi ndarjes me batalionin "Asim Zeneli" që ishte krijuar tek rrepet e Kardhiq-Prongjisë (7.8.1943). Pas vrasjes së komandantit të batalionit të rinisë Karafil Bello më 2 shkurt 1944 tek te Çuka e Kuqe në Senicë, batalioni i rinisë u bë pjesë e Grupit të parë partizan të ZIOP dhe u emërtua batalioni "Karafil Bello". Gjithë zhvillimet në Fushëbardhë Xhezua i ndoqi deri në ditën që u shua, pasi shpirti dhe mendja e tij ishte trupëzuar me vëndlindjen.

Fushëbardha me rrënjë të thella të lirisë, e donte Xhezon dhe gjithë dëshmorët e saj në tokën e vet, por vendimet e kohës ngritën varrezat e dëshmorëve të rrethit, ashtu sikurse janë 36 grup-varrezash të dëshmorëve në të gjithë Shqipërinë. Përpjekjet për të marrë seshtrat u bënë nga babai i tij Dervishi që në vitin 1947, që kishte kërkuar të merrte eshtrat e djalit në Labinot të Elbasanit. Kohët kishin ndërruar. Nuk praktikohesh më tradita zakonore e varrimit të dëshmorëve, "ku i zinte balta". Kështu që një vit më vonë, më 1948 i vëllai i dëshmorit, Babudeni shkoi në Elbasan. Katër vite e kishte ruajtur toka të patretur, si duket amaneti i lirisë. Ai shprehej: "unë isha i madhi, megjithëse Xhakua e trajtonte Xhezon si të madh që kur ishte i vogël;...kur e ngritëm nga toka eshtrat e tij m'u duk sikur më tha:

"ç'bëni more se më dërmuat! Xhezon e pashë edhe një herë si të gjallë".

### BRIGADA PARTIZANE E XHEZO PRODËS, BRIGADË HEROINË

Në Fushëbardhë në tetë deada për brigadën e gjashtë sulmuese ose "Brigadën e Labërisë", thuhej "Brigada ku luftoi Xhezua, Alemi, Tahiri, Kutbiu, Latifeja...", ndërkohë që brigada ishte sikurse është etiketuar, "Brigada që tundi dhenë,/në popull ngriti follenë,/ atje jataku dhe shpirti,/lavdinë më lartë e ngriti,/... Brigada e VI-të u themelua nga shkrija e çetave "Çerçiz Topulli", "Hajredin Tremishti", "Avni Rustemi" dhe "Toto Bolena", edhe pse fakt është se brigada u krijua mbi bazën e 4 batalioneve.

Me këto çeta u krijua batalioni "Asim Zeneli". Brigada VI sulmuese ishte formacioni lavdie i UNÇSH-së, që gdhendi emrat e partizanëve dhe dëshmorëve në historinë e kombit tonë. Batalioni "Asim Zeneli" i krijuar në rrepet e Kardhiqit e Prongjisë më 7.8.1943, batalioni "Baba Abaz" krijuar në Kalivaç të Tepelenës më 10.8.1943, batalioni "Naim Frashëri" në Garzema të Përmetit më 21.9.1943, batalioni "Abaz Shehu" i krijuar më 12.12.1943 në Fushëbardhë, pas ndarjes së batalionit "Asim Zeneli", si dhe batalioni i pestë ishte batalioni partizan "Zaho Koka".

Partizanët e këtyre batalioneve kishin marrë pjesë në luftimet kundër forcave fashisto-naziste si në Cepo, Ura e Kardhiqit, Libohovë, Shkallë të Zezë, Tepelenë, Mezhgoran, Kiçok, Rrëzomë, Kurvelesh, Mesaplik etj, u përfshinë në BVI Sulmuese, përveç batalionit "Misto

Mame", i cili u inkuadrua më vonë në brigadën VIII Sulmuese.

Këto batalione kishin përshkuar një rrugë të vështirë e të lavdishme luftarake. Ato i kishin shkaktuar armikut qindra të vrarë, të plagosur e robër, kishin kapur shumë materiale luftarake, armë automatike, pushkë, topa, murtaja e municione të shumta. Formimi i brigadës VI Sulmuese gëzonte jo vetëm partizanët, por edhe popullin e qarkut të Gjirokastrës.

Në thirrjen e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Qarkut thuhej: "Edhe në Gjirokastrën tonë të çëqove të vejtër e të rinj, do të formohet Brigada VI Sulmuese. Ata që përbëjnë këtë brigadë janë djemtë e krahinës dhe të qarkut tonë, që me gjakun e tyre kanë çliruar zonat të tëra e do të vazhdojnë për ta shkaktërruar armikut plotësisht.". Brigada e VI Sulmuese "Heroinë e Popullit", që numëronte 912 partizanë nga të cilët 120 vajza e gra dhe 60 ponierë luftime, ndërkohë që efektiv i saj u rrit në 1700 luftëtarë.

Drejtimesit e brigadës e shkruan biografinë e tyre me luftime të përgjakshme, por të sukseshme. Në kohën e krijimit BrVIS kishte: komandant Tahir Kadareja, nënkomandant Jaho Gjoli-ku, komisar Mustafa Matohiti, zv/komisar Haki Toska; më seksionin politik Adil Çarçani, Zihni Sako, Sami Gjebero, Siri Çarçani, Vangjelo Sotiriadhi, i identifikuar Hetem Pogaçe e ndihmës Braho Toto, për shëndetësinë Nedin Kalanxhi, ndihmësmjek, për ndërlidhjen Muhedin Bakiri, komandant batalionesh ishin Riza Veipi, Sadik Buzo, Fejzo Ismaili, Feti Bubsji, Maksut Myrtaj, nënkoman-

dantë batalionesh Astrit Nishani, Musa Daci, Mustafa Asllani, Meleq Gostin-ishi, zëvendëskomisar batalionesh Ago Çeli, Veledin Zeneli, Petrit Radovicka, Mitro Xhani, Abdul Hakiu, Asaf Dragoti,..e kuadro të tjerë si Sotir Filto, Xhule Çiraku etj, që spikatën në betejat e shumta të kësaj brigade. Lufta e partizanëve të BrVIS çliroi 8 qytete e 32 krahina, që përmes luftimesh të përgjakshme të 5 batalioneve të saj në një rrugëtim historik luftimesh prej 3700 km ndoqi nazistët deri në Vishegrad, por la në fushën e nderit 220 "Dëshmorë të Atdheut" dhe 10 "Heronj të Popullit" që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë, por që pati edhe 540 partizanë të plagosur disa nga të cilët ndërruan jetë nga plagët e marra në luftë dhe që në bazë të ligjit meritojnë titullin e lartë "Dëshmor". Nga Fushëbardha ka pasur me dhjetra bijë e bija që kanë ngelur emra të gdhendur në historinë kombëtare, ku vetëm nga Fushëbardha kanë rënë dëshmorë nga formacioni i BrVIS: Alem Zano Shehu dhe Tahir Reis Xhuvani (15.4.1944), Kutbi Çelo Gjeçi (25.7.1944), Xhezo Dervish Proda (10.9.1944), Latife Veli Nora (25.3.1945) në Suhagorë të Bosnjë Hercegovinës.

Eshtrat e Xhezo Prodës prehen në Gjirokastër në piedestalin ku nderohen të rënë e kombit shqiptar. Xhezo Dervish Proda është shpallur me titullin e lartë të nderit "Dëshmor i Atdheut" me Vendim të KE të KP të rrethit Gjirokastër nr. 65 datë 2.10.1971 si dhe është njohur në bazë të ligjit dhe Vendimit nr.4 datë 27.11.2002 të Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmor i Atdheut".

## IN MEMORIAM

*Që në fillimet e para të LANÇ, tek ai lindi mendimi demokratik europian, pjesë e të cilit jemi*

**• Ai ishte organizator i shumë betejave dhe aksioneve (si beteja e Gjormit, Dhjetor 1942) ku u vra koloneli italian Clemente, lufta në Dukat, në qafën e Dushkut, në Vojzë e Selenicë etj**

# SKËNDER MUÇO, NJERIU QË I DHA EMER HISTORISË



## DAUT HOXHA

**H**istoria e një kombi dhe një populli vjen nga thellësia e shekujve, së bashku me ngjarjet dhe momentet kulmore të saj. Në këtë hapësirë kohore këto ngjarje dhe momente mund të përshpejtohen apo të ngadalësohen nga individë dhe personalitete të veçanta apo në grup.

Në plejadën e këtij kontingjenti që i dha shtysë zhvillimit do të renditej Skënder Muço, mendimtar, legjislator dhe organizator i veprimit demokratik për zhvillimin në shumë plane.

Ai lindi në ato vite ku sapo nisi e ardhmja e shtetit modern shqiptar. Kjo jehonë do ta shoqëronte gjithë jetën e tij të pastër prej intelektualit demokrat me vizion të qartë iluminist europian falë kulturës së pasur e të gjerë të tij.

Ai lindi në një familje me tradita patriotike dhe arsimdashëse, ashtu si e gjithë krahina e Dukatit, ku bën pjesë dhe fshati i tij Tragjasi.

I ati, Dauti, luftëtar i pavarësisë dhe daja, Alem Tragjasi, pjesëmarrës në ngjarjet madhore si ajo e 28 Nëntorit 1912 dhe më pas në Luftën e Vlorës 1920, lanë gjurmë të pashlyera tek Skënderi i vogël dhe në gjithë rininë e tij. Më vonë koha zulummadhe do të bëhej prologu dhe epilogu i jetës dhe i gjithë veprimtarisë së tij!

U arsimua nga fillorja deri në universitet në Itali, falë kujdesit të dajës Alem. Atje shumë shpejt do të bjerë në kontakt me idetë demokratike, iluministe dhe patriotike të rrethit universitar dhe të mërgimtarëve politikë.

“Skënder Muço, - shkruan Halim Xhelo Tërbaçi, - punon shumë në Itali për çështjen shqiptare”. Ai bashkëpunon me organet e shtypit të kohës, ku shpreh me zjarr idetë dhe vlerat e tij patriotike dhe demokratike.

Koha e studimeve në Itali për Skënder Muçon nuk ishte vetëm pjesë e kualifikimit dhe të laurimit të Jurisprudencës, por njëherazi si moment akumulimi i ideve dhe dhe lëvizjeve progresiste. Ai gjatë kësaj kohe merr takim me gjithë spektrin politik në emigracion, si nga e djathta dhe nga e majta. Do të veçonim këtu Mit’hat Frashërin, Zoi Fundon, Mustafa Gjinishin, Sejfulla Malëshovën, Musine Kokalarin, Halim Xhelon, Ymer Dishnicën, Omer Nishanin e të tjerë.

Kjo njohje i dha mundësi të bashkëpunojë me një sërë organesh shtypi që botuan këtë personalitet, si “Liria Kombëtare”, “Sazani”, “Kombi” etj. Ky bashkëpunim dhe kjo veprimtari politiko-shoqërore e çoi atë drejt qëmtimit të vlerave të Alternativës ndryshe, duke i vlerësuar ato në gjithë planet. Pikërisht kjo mendësi veprimi bëri që ai të përqafojë dhe të bëjë të tijat idetë e socializmit demokratik europian që gjetën gjatë Luftës Antifashiste zbatim dhe afishim të Alternativës Socialdemokrate në Shqipëri.

Ishte bashkëpunimi me Musine Kokalarin, Mustafa Gjinishin, juristin Abaz Omari e të tjerë që, siç shkruan Musine Kokalari në “Ditarin” e saj ... “u mblodhën në një shtëpi tiranase në rrugën e Elbasanit ... Atë e organizoi Skënder Muço, ishin mbledhur aty rreth 60 burra, fjalën e mbajti

Skënder Muço, ai foli për luftën dhe dëshirën për bashkim me Frontin, dhe po aty deklaroi formimin e Partisë Socialdemokrate ... Kjo ka ngjarë në ditët e para të Tetorit të vitit 1943 ...”

Pra, e thënë me gjuhën e historisë, Partia Socialdemokrate është themeluar më 3 Tetor 1943. Ideatorët e kësaj Alternative janë: Musine Kokalari, Skënder Muço, Sejfulla Malëshova, Mustafa Gjinishi e të tjerë.

Po aty u vendos botimi i një organi të PSDSH, detyrë që iu ngarkua Musine Kokalarit e Skënder Muços; organi “Zëri i Lirisë” doli në kushtet e ilegalitetit dhe u arrit të botohen vetëm 6 numra. Gjithsesi këto pak numra të botuar në hapësirë kohe të ndryshme mjaftuan për një platformë bindëse në shërbim të çlirimit të vendit dhe të çështjes shqiptare, ku Skënder Muço është njohës i mirë i saj dhe diti të orientojë PSD drejt vlerësimit të gjetjes së aleatëve dhe aleancave në shërbim të saj. Kjo Alternativë e udhëhequr nga Musine Kokalari dhe Skënder Muço e gjeti veten tek Aleanca Antifashiste Demokratike, nën drejtimin e Anglo-Amerikanëve e B. Sovjetik.

Kjo gjetje e Skënder Muços dhe Musine Kokalarit ra ndesh me një pjesë të nacionalizmit që e atashuan veten tek “Aleanca e Boshtit Berlin-Romë-Tokio”.

E gjithë kjo veprimtari në kuadrin e Alternativës SD nuk mund të veçohet nga bashkëpunimi me Mustafa Gjinishin, Gjergj Kokoshin, Shefqet Bejën, Murat Myftar Tërbaçin, Qazim Kokoshin, Ymer Dishnicën etj.

Pas studimeve kthehet në atdhe. Ai tashmë vjen i kompletuar si intelektual në fushën e Jurisprudencës dhe të një veprimtarie me përvojë në fushën e menaxhimit ndryshe.

Si avokat dhe qytetar ai dallohet për bindjet e tij republikane dhe i takon brezave të mendimtarëve të viteve '30. Gjatë kësaj kohe ka një veprimtari të dendur publicistike të shkruar dhe boton tek “Bota e Re” e “Kombi”. Takimi dhe njohja me gazetarin republikan Merxhani dhe të riun Petro Marko i japin nxitje dhe furi shkrimeve të tij; kjo gjë u afishua në lëvizjen e Vlorës të vitit 1932 ku do

të arrestohet dhe, me gjithë mbrojtjen brilante të shokëve dhe vetes së tij, dënohet me vdekje. Vendimi nuk u ekzekutua falë lëvizjeve popullore dhe “Petitionit” të popullit të Vlorës drejtuar Nënës Mbretëreshë që do t’ia falë jetën dhe vuan një dënim me heqje lirie 3 vjet.

Edhe pasi doli nga burgu veprimtaria e tij nuk rreshti. Ai ishte për ndryshimin e sistemit politik monarkik. Koha e zgjedhjeve pluraliste e vendosi Skënder Muçon në krahun demokratik republikan. Zgjedhjet bashkiake komunale të vitit 1936 ndryshuan qeverisjen vendore, ku fitoi krahu reformator, duke sjellë ide demokratike me mendësi qytetare. I gjithë ky ndryshim u ndërpre nga pushtimi fashist i vendit më 7 Prill 1939.

Si gjithmonë, doli në pah vlera kombëtare dhe në ballë ishin intelektualët veprimtarë brenda dhe jashtë vendit.

Në këto momente dallohen disa cilësi të veçanta të tij si orator, legjislator, njohës i së drejtës ndërkombëtare, çka bëri që jo vetëm ta orientojë drejt e mirë veten, por u bë motorri i një lëvizjeje të organizuar antifashiste.

Ai ishte në ballin e lëvizjes popullore e studentore dhe njëherazi ideator për “Bashkim Kombëtar” pa dallim feje, ideje e krahine.

Pikërisht kjo veprimtari e gjerë politike e ushtarake ra në sy të fashistëve dhe nazistëve, që menjëherë reaguan ndaj tij dhe familjes Muço, çka e detyruan Skënder Muçon të hidhej në ilegalitet. Këtu ai dallohet në organizimin e rezistencës antifashiste së pari në Mallakastër e më pas në Tragjas e Hekal. Ai ishte organizator i shumë betejave dhe aksioneve (si beteja e Gjormit, Dhjetor 1942) ku u vra koloneli italian Clemente, lufta në Dukat, në qafën e Dushkut, në Vojzë e Selenicë etj.

Gjatë viteve 1942 – 1943 ai kryen veprimtari të shumta patriotike me idenë e bashkimit të mbarë popullit shqiptar në Luftën Antifashiste, ai merr pjesë në Konferencën e Pezës dhe të Mukjes. Ka qenë nismëtar i shumë takimeve në rrethin e Vlorës me Frontin Nacionalçlirimtar si misionar i bashkimit; në gjithë këtë veprimtari ai ka afishuar mendimin socialdemokrat si alternativë progresiste. Në këtë kuadër, ai bashkë me Musine Kokalarin, Mustafa Gjinishin, Ymer Dishnicën bëri të vetën direktivën e Internacionales Socialiste të organizimit të “Frontit Popullor” dhe të gjithë anëtarëve të Aleancës Antifashiste Demokratike, Aglo-Amerikanëve e B.Sovjetik.

Këtu ai do të kundërshtonte, ashtu si dhe Musine Kokalari, traktatitn “Dalmazzo – Këlcyra” si një moment antikombëtar që do të pengojë bashkimin e popullit shqiptar në luftë për çlirim. Ai është kundër bashkimit të trojeve shqiptare nën ndikimin e traktatit “Boshti Berlin, Romë, Tokio”. Motoja e tij ishte “Aleanca Demokratike Antifashiste”. Si jurist dhe si njohës i të drejtës ndërkombëtare ai ishte largpamës dhe enkas propagandonte “Kartën e Atlantikut” dhe Deklaratën e 12 Dhjetorit 1942 të bërë në emër të “Aleancës Antifashiste Demokratike” nga Iden, Ministër i Jashtëm i Qeverisë Britanike.

Pra, që në fillimet e para të Luftës Antifashiste, tek ai lindi mendimi demokratik europian, pjesë e të cilit jemi.

Njohja e të drejtës ndërkombëtare, për atë si politikan dhe mendimtar, bëri të mundur orientimin për një politikë të drejtë të njohjes e të zgjidhjes së çështjes shqiptare në mbështetje të marrëveshjeve ndërkombëtare si ajo e Teheranit, Jaltës e Poznanit.

Skënder Muço u bë koordinator me Misionet

## 105 VJETORI I LINDJES

## Halil Veli Bala, bir i denjë i Shkodrës dhe Shqipërisë!

Nga Xhevat Mustafa

Shkodra ka qenë ndër shekuj djep bijsh e bijash që kanë bërë histori e kanë mbetur në histori dhe në krijimtarinë folklorike, letrare, figurative, në botimet shkencore e historike...me emrat, veprat, sakrificat, ndihmesat... e tyre në mbrojtje të lirisë e të çdo pëllëmbë toke shqiptare. Lista e tyre është e moçme dhe e gjatë. Në këtë djep është përkundur në foshnjëri dhe më vonë, pasi e ka kaluar këtë moshë, është rritur e burrëruar edhe Halil Veli Bala, një njeri i spikatur në disa drejtime.

Ai u lind 105 vjet më parë, më 19 shkurt 1920, në një familje të vjetër qytetare shkodrane në lagjen "Rus i vogël" dhe që gëzonte respekt për shqiptari e qytetari, për ndershmëri e bujari në Shkodër e përtej saj... Babai i tij, Veliu punonte si mullali, predikues i fesë islame! Ndryshe nga disa të tjerë, ai bëri kujdes dhe ia arriti të shmangte fanatizmin radikal fetar, duke u përpjekur me zgjuarsia e takt për bashkëjetesë sa më paqësore me vëllezërit dhe motrat e fesë katolike. Prandaj mes tyre pati edhe jo pak shokë të mirë gjatë jetës së tij të shkurtër. Ai vdiq në moshë të re, duke i lënë gruan e ve dhe fëmijët e vegjël, në një periudhë kohore të vështirë, sidomos për nga papunësia e varfëria...

Ndërsa nëna e Halilit ishte bijë e familjes së njohur shkodrane Çaku...! Dy prindërit u përpoqën dhe ia arritën me sakrificë jo të pakta edhe për shkollimin e Halilit, për t'u bërë sa më i aftë për të punuar e jetuar me djersën e ballit e të duarve të tij. Pas përfundimit të shkollimit fillestar Halili u regjistrua në Kolegjin Franceskan, ku kishte një ekip mësuesish me nivel të spikatur profesional dhe të përkushtuar ndaj nxënësve të tyre. Këtu pati shok klase edhe At Zef Pllumin, i cili më vonë do të bëhej personalitet me njohje kombëtare e ndërkombëtare si klerik, poet e si studiues...Pas përfundimit të këtij Kolegji, dajati e tij, Jonuz dhe Ramo Çaku, të cilët ishin në gjendje të mirë ekonomike, e ndihmuan Halilin të vazhdonte studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Casertas në Itali. Vitet e studimeve e të jetesës në këtë Akademi të njohur e ndihmuan për t'u bërë një ushtarak me nivel të kënaqshëm profesional, në standardin e përparuar të ushtrisë italiane. Pasi u diplomua me nota e rezultate të lavdërueshme u kthye në Shkodrën e tij. Nuk iu desh të priste gjatë, sepse u emërua si oficer policie në Vlorë dhe Elbasan. Edhe gjatë viteve



• **Halil Balën e nderon si oficer e si njeri, me tolerancë qytetare e fetare, edhe një kujtim nga At Zef Pllumi në librin e tij, "Rrno vetëm për me tregue". Ai shkruan për një episod që ka lidhje me Halil Balën, ish shokun e tij të klasës në Kolegjin Franceskan. Kur kishin ardhur për të kontrolluar në kishën ku ishte At Zef Pllumi, pa u futur fare në dhomën ku jetonte ky personalitet i shquar i katolicizmit shqiptar e botëror, Halili kishte shënuar dukshëm: "U kontrollua!!" Kështu At Zef Pllumbi shpëtoi nga një kontroll keqdashës apo me paramendimin për ta penalizuar**

të shërbimit në këto dy qytete Halili spikati edhe për përkushtim në detyra, edhe për përkujdesje për të mos kapërcyer caqet apo limitet si ushtarak e si njeri. Prandaj, kur u largua nga këto qytete, la prapa miq e shokë të mirë, respekt e kujtime pozitive edhe tek shumica e qytetarëve.

Me fillimin e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare e me krijimin e njësiteve të para partizane, qysh më 1942 Halili u bashkua me njërin prej tyre, si partizan. Ndërsa në tetor 1942 u pranua edhe si anëtar i Partisë Komuniste. Duke ia njohur arsimimin si oficer dhe korrektesën në detyra u transferua në Përmet. Kjo lëvizje e re pati të mirën e madhe se në Përmet u njoh me Marikën, vajzë nga një familje shumë e njohur përmetare, bijë e Mandi Mamanit, tregtar i mesëm. Pas martesës nuk hoqi dorë edhe nga pjesëmarrja në luftën partizane. Në luftime u plagos dy herë, fatmirësisht jo rëndë e pa rrjedhoja të përjetshme fizike.

Për meritat gjatë periudhës së luftës, nga Presidiumi i Kuvendit Popullor u nderua me tri medalje, "Medaljen e trimërisë", "Medaljen e kujtimit" dhe "Medaljen e çlirimit". Këto akte apo fakte nderimi janë ruajtur me përkujdesje e respekt nga familja, deri më sot. Me çlirimin e vendit, Halili punoi si oficer artilerie

në Gjirokastrë, Sazan dhe në Tiranë, në Ministrinë e Mbrojtjes. Në këto vite çiftit Bala i lindën tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë.

Në vitin 1951 ai lirohet nga detyrat si ushtarak dhe caktohet me detyrën e shefit të seksionit të bujqësisë për rrethin e Shkodrës. Kur fëmijët ishin akoma të vegjël jeta e tij do të merrte një kthesë të papritur, të padëshirueshme e të pamerituar...Siç ishte e shpeshtë gjatë atyre viteve të para të pas çlirimit, atij iu harruan meritat si ish partizan e si komunist, edhe tri medaljet dhe iu kujtua vetëm "mëkati" apo "faji" se ishte diplomuar si oficer në Akademinë Ushtarake të Casertas dhe se "gjatë kryerjes së detyrave kishte pasur edhe disa dobësi në punë"? Përveç këtyre, akuza iu shtua e rëndua me tendencë edhe pse "i kishte dhënë ndihmë disa njerëzve të klerit katolik"!

Halil Balën e nderon si oficer e si njeri, me tolerancë qytetare e fetare, edhe një kujtim nga At Zef Pllumi në librin e tij, "Rrno vetëm për me tregue". Aty nga faqja 95 ai shkruan për një episod që ka lidhje me Halil Balën, ish shokun e tij të klasës në Kolegjin Franceskan. Kur kishin ardhur për të kontrolluar në kishën ku ishte At Zef Pllumi, pa u futur fare në dhomën ku jetonte ky personalitet i shquar i katolicizmit shqiptar e botëror, Halili kishte shënuar duk-

shëm: "U kontrollua!!" Kështu At Zef Pllumbi shpëtoi nga një kontroll keqdashës apo me paramendimin për ta penalizuar.

Në fillim për Halilin u dha dënimi me vdekje- pushkatim. Pastaj ia ulën dhe e dënuan me 25 vite burg. Pas ankimeve në hallkat e drejtësisë e të pushtetit në Shkodër e Tiranë, masa e dënimit iu ul ndjeshëm dhe mbeti në 10 vjet. Si njeri me karakter e kurajë të fortë dhe me humor, edhe kur ishte në qeli, ai dinte t'i përmbante e t'ua fshihte të tjerëve, edhe njerëzve të dashur të familjes, edhe atyre në burg dhimbjet e "plagëve" të shpirtit dhe zemrës së tij! Gjithësesi, këto 10 vjet burg, për më tepër në kushte tmerrësisht të këqija për jetesë e ushqim, kishin vrarë ndjeshëm fizikisht e moralisht. I mbeti peng deri në frymën e fundit mosmirënjohja e treguar ndaj tij për shumëçka kishte bërë e sakrifikuar gjatë kryerjes së detyrave shtetërore e sidomos gjatë viteve të LANÇL.

I dhanë një vend të thjeshtë pune në Ndërmarrjen e Ndërtimit në Shkodër, shumë më poshtë nivelit të tij të arsimimit, të përvojës dhe meritave... Edhe në këtë ndërmarrje ai punoi siç e kishte në natyrë, me përkushtim e korrektesë. Prandaj la përshtypje të mira edhe tek drejtuesit, edhe tek bashkëpunëtorët e thjeshtë.

Nga sa u kuptua më vonë, vitet e burgut, ia kishin dëmtuar rëndë e pashërueshëm zemrën. Prandaj, pas një ataku kardial të papritur, zemra e Halil Balës pushoi së rrahuri në dhjetor 1980, kur ishte pak muaj më shumë se 60 vjeç dhe pa arritur ta gëzonte pensionin!

Por, iku edhe me ngushëllimin dhe gëzimin se po linte pas tre fëmijë për së mbari, me familje e me plot nipër e mbesa! Edhe pas kaq shumë vitesh, të gjithë e kujtojnë me dashuri dhe krenari babain dhe gjyshin e tyre!

## SKËNDER MUÇO, NJERIU QE I DHA EMER HISTORISË

(Vijon nga faqja 8)

Aleate dhe në bisedime me ata afishoi pikëpamjet socialdemokrate dhe detyrat rreth së ardhmes së bashkimit të kombit tonë, mbështetur në marrëveshjet e Aleancës Demokratike Antifashiste, pjesë e së cilës ishte

dhe lufta jonë antifashiste.

Ai ra në fushën e nderit, atje ku e thirri zëri i atdheut. Kapet më 7 gusht 1944 nga gjermanët, kur po shkonte në Vlorë. U ekzekutua tri ditë më vonë në fshatin Bubullimë të Lushnjës. Koha po vërtetonte gjithë veprimtarinë e av. Skënder Muços,

këtij mendimtari socialdemokrat dhe patriot, në gjithë planet e saj. Vepra e tij është apel për të sotmen dhe të ardhmen e kombit dhe vendit tonë, për demokracinë e brishtë shqiptare dhe njëherazi ngushtimin e tranzicionit për zhvillim e prosperitet të popullit shqiptar.

## EDITORIALI

# Korrupsioni zgjedhor, OBVLP mbështet strategjinë e SPAK

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

(Vijon nga fq. 1)

Në këtë kuadër, OBVLP mbështet fuqimisht Strategjinë e publikuar nga Prokuroria e Posaçme për të hetuar në kohë reale problemet që lidhen me shit-bleren e votës, përdorimin e burimeve shtetërore si dhe përfshirjen e krimit të organizuar në procesin zgjedhor. Në strategjinë e publikuar nga SPAK evidentohet shqetësimi i vazhdueshëm i organizatave vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë OSBE/ODIHR, Komisionin Evropian dhe Misionin Amerikan pranë OSBE-së, lidhur me veprat penale në kuadër të zgjedhjeve në Shqipëri.

Një tjetër problem që pritet të jetë në vëmendjen e SPAK është edhe përfshirja e krimit të organizuar në procesin zgjedhor. Hetimet e kryera së fundmi nga SPAK kanë ekspozuar lidhjet e thella mes krimit të organizuar dhe



politikës, si dhe ndikimin e tyre në procesin zgjedhor – duke deformuar sipas ekspertëve votën e lirë dhe sistemin demokratik të vendit.

“Nga ana tjetër, kjo strategji synon të parandalojë ndikimin e krimit të or-

ganizuar në integritetin e procesit zgjedhor, përmes masave konkrete dhe përdorimit sa më efektiv të teknikave të posaçme hetimore,” thekson SPAK.

Për të mundësuar zbatimin e strategjisë, është parashikuar që të ngrihet

një grup hetimor që do të përbëhet nga një strukturë qendrore dhe grupet hetimore që do të veprojnë në terren për të monitoruar në kohë reale situatat e dyshuara; që të identifikojnë individët dhe anëtarët e krimit të organizuar të përfshirë në korrupsion në zgjedhje; për monitorimin e përdorimit të buxhetit, investimeve dhe infrastrukturës publike, të cilat nuk lejohen të kryhen gjatë periudhës zgjedhore nga subjektet e posaçme, etj.. Po ashtu, parashikohet që të mundësohet komunikimi në kohë reale me publikun dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; si dhe të ngrihet një platformë në faqen zyrtare të SPAK, për denoncimin e rasteve.

SPAK synon gjithashtu, që të identifikojë zonat ku janë shfaqur më parë raste të veprave penale në kuadër të zgjedhjeve, që të përqëndrojë aty burime hetimore.

Një tjetër flamur i kuq që ngre SPAK lidhet me mundësinë e keqinformimit të opinionit publik nga ana e medias nëpërmjet lajmeve të pavërteta mbi hetimet e krimeve zgjedhore apo edhe denoncimet e rreme që mund të devijojnë fokusin nga rastet reale.

Kjo për faktin se sipas SPAK “Grupet kriminale, për interesat e tyre të paligjshme shpesh ndërhyjnë në procesin zgjedhor përmes kërcënimeve, manipulimeve financiare, korrupsionit të zyrtarëve zgjedhorë, etj”.

## PORTRET

### Irfan Lulo, pedagogu shembullor i artilerisë

Zef RROZHANI

Të shkruash për një personalitet të tillë elitë mes njerëzve të ditur dhe të përkushtuar nuk është gjë e lehtë, sepse sado të thuash duket sikur ke thënë copëza nga puna dhe jeta e tyre. E një ndër ato është edhe Irfan Lulo. U lind më 10 shkurt 1939 në një familje të thjeshtë atdhetare në fshatin Baban të Devollit. Pasi mbaroi shkollën 7-vjeçare me rezultate shumë të mira dëshira e tij ishte të bëhej oficer. Fuat Babani fillon studimet në shkollën e oficerave ku e mbaroi me rezultate të shkëlqyera me gradën N/Toger në degën Artileri Tokësore. Sapo hyri në jetën ushtarake mori pjesë në stërvitje ushtarake me artileri ku u shqua për përgatitje të shkëlqyera në çdo aspekt. Për aftësitë e tij dhe përkushtimin

• Pas daljes në rezervë me një grup devollinjsh që banojnë në Tiranë, në vitin 1996 krijuan shoqatën kulturore Atdhetare “Devolli”. Irfani u zgjodh unanimisht kryetar ku pjesëmarrës ishte i paharruari Dritëro Agolli ku u dha tre porosi, të cilat edhe sot i ruajnë me fanatizëm

për 11 vjet kreu detyra të ndryshme në repartet ushtarake të korpusit të Korçës, deri në komandant reparti artilerie, si në Pogradec, Mokër, Devoll, Çeravë etj.

Në shtator të vitit 1971 filloi studimet në Akademinë Ushtarake. Edhe pse ishte akademist, ishte pjesëmarrës në stërvitjen e armatës të quajtur “Peza” në vitin 1972. Ajo stërvitje ku ndiqej nga oficerë të huaj u vlerësua me nota shkëlqyeshëm si arterielë të mirë pregaditur. Më 30 korrik 1973 përfundon studimet me rezultate të shkëlqyera Akademinë Ushtarake, emëruar Pedagog në shkollën e Artilerisë.

Përpara këtij oficeri të ri, tashmë pedagog dilyn detyra për të cilat kishte mësuar dhe betuar më së miri.

Pas disa kohësh shkolla e Artilerisë u bashkua me shkollën e Bashkuar. Katedrat ishin njësi bazë e punës mësimore dhe studimore të cilat vareshin nga dega mësimore. Si një pedagog që e vlerësonte punën e tij për të kishte rëndësi stërvitja e vogël dhe përgaditja fizike. Më 1 Prill të vitit 1975 në Zall Her të Tiranës u krijua e para shkollë e përgaditjes se kuadrove rezervistë. Deri në atë kohë detyrën e oficerëve rezervistë e kryenin kuadro që kishin përfunduar Universitetin e Tiranës, kishin bërë kursin pas universitar prej 5 muajsh. Në Zall Her përgaditeshin kuadro për të gjitha llojet e armëve. Por mbi të gjitha i ishte kushtuar përgaditjes fizike. Për këtë ishte ndërtue një kullë e lartë, ku bëheshin hedhjet me parashutë.

Duhet thënë se arsimi ushtarak dhe mësimdhënësia ishin të përkushtuar. Oficerët të çdo lloj arme ishin artistë të spikatur. I tillë ishte edhe oficeri dhe pedagogu Irfan Lulo. Me firmën e tij janë diplomuar me dhjetra oficerë të Artilerisë. Për dy dekada me radhë ju përkushtua mësimdhënies në katedrat, ku edukoheshin dhe mësonin drejtuesit e ushtrisë shqiptare. Ai njihet gjithashtu si një ndër specialistët më të spikatur të Artilerisë. Irfan Lulo ka firmosur dhjetra diploma të kursantëve të shkollës oficerave rezervistë e aktivë të dalë nga shkolla e Zall Her-

it deri më 30 korrik 1992, ku shërbeu në shkollat ushtarake Tiranë me detyrë pedagog, zv. shef dhe shef katedre artilerie në shkollën e oficerave rezervistë. Për 35 vjet të shërbimit në Forcat e Armatosura, Irfan Lulo është dekoruar me urdhërin e shërbimit ushtarak, me Medaljen e Shërbimit ushtarak, me urdhërin “Për shërbime të shquara shtetërore dhe shoqërore si dhe me urdhërin “Ylli i Kuq “. Përveç të tjerave ai ishte një bashkëshort ideal dhe prind shembullor, baba i katër fëmijëve ku sejcili do trashëgojë vlerat brilante të Irfan Lulos. Por edhe pas daljes në pension i respektuar si askush në vitin 1992 ai nuk ndenji i qetë si disa që vrasin kohën. Kështu pas daljes në rezervë me një grup devollinjsh që banojnë në Tiranë në vitin 1996 krijuan shoqatën kulturore Atdhetare “Devolli”. Irfani u zgjodh unanimisht kryetar ku pjesëmarrës ishte i paharruari Dritëro Agolli ku u dha tre porosi, të cilat edhe sot i ruajnë me fanatizëm. Së pari shoqata të mos jetë me anëtarë “elitë” sepse do jetë e ngushtë. Së dyti shoqata duhet të jetë “laramane”, pa dallim bindjesh politike. Së treti duhet të ketë veprimtari të larmishme. E pra këto porosi po ndiqen rregullisht edhe sot. Marjana, vajza e Irfan Lulos thotë sed ne fëmijët e Mamaja, sëbashku me miqtë tanë Devollitë e kujtojmë çdo 10 shkurt babain dhe mikun e të gjithëve në ditlindjen, që në këtë shkurt do ishte 86 vjeç, i ndarë nga jeta 82 vjeç. Vdes ai që harrohet.



## HISTORIKU

104 VJETORI I ARMËS së XHENIOS (20 JANAR 1921-20 JANAR 2025)

# Lavdi 5 heronjve, dhe 160 dëshmorëve të Armës Xhenios

Nga Zabit Çuku\*

**M**ë 20 janar 1921, me vendim të qeverisë të dalë nga Kongresi Lushnjës, krijohet Kompania e Parë Xheniere me 150 ushtarë, 5 oficerë në Divizionin e Ushtrisë Kombëtare, me detyrë punime infrastrukture, kazerma, rrugë, ura e tjera.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu një strateg ushtarak krijoi e përdori elementë të sigurimit xhenier të kohës, si maskim, mashtrim, pritje, hedhjen e gurëve, të bllokim rrugëve, grykave, hapjen e shkëmbenjve për të mashtuar e kaluar trupat e veta, zjarret me prodhim tymi e barute djegëse, tymet në pika të dukshme, deri, te gurhedhësi shqiptar i cili njihet edhe në ditët tona.

Në vitin 1928 u krijua komanda e parë e trupave xheniere. Në vitin 1929 ishin 10 kompani xheniere, për nevoja të ushtrisë e komunitetit. Pushtimi fashist më 1939, e shkatërroi plotësisht ushtrinë dhe repartet xheniere.

Gjatë viteve 1933-1935 shumë studentë shqiptarë ishin në shkollën e Aplikacionit Artleri - Xhenio në Torino që e mbaruar me rezultate të larta, por ditën e betimit ata tradhëtuan flamurin Italian e u kthyen në Shqipëri për çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Në LANÇ shumë partizanë luftëtarë përgatitën disa elementë të veprimit e sigurimit xhenier si lufta me mina, pengesa shaktërrime e tjera.

Më 10 prill 1944, sipas Urdhërit Nr. 116 i SHPUNAÇL u përgatitën dhe dolën skuadrat e para minatore - zapatore, në mbështetje të veprimeve luftarake në njësitë partizane deri në ngritjen e barrikadave për Çlirimin e Tiranës dhe më pas në mbrojtje të atdheut.

Nga komanda e SHPU më 26 maj 1945, krijohet reparti i parë xhenier, (batalioni Zaporator-Minator) Laprake. Drejtor i Komandës së Xhenios ishte majori Njazi Çepani, komandant batalioni Majori Kadri Ibrahim. Me dy kompani, u vendos në plazhin e Durrësit për të kryer çminimin e bregdetit të minuar nga pushtuesit nazi-fashistë në ikje e sipër.

Ushtria gjermane në harkun kogor 1943-1944 minoi rreth 400 kilometra gjatësi në bregdetin shqiptar, nga Saranda, Lumi i Matit e Shëngjin me 100 mijë mina kundërtanke e 200 mijë mina kundërkëmbësorisë. Trupat xheniere në shkëmbi i Kavajës hoqën mbi 8 mijë mina kundërtanke e 2 mijë mina kundërkëmbësorisë deri në shtator 1945. Aty ranë heroi-kisht dëshmorët: kapiten Panajot Haxhimihali, Zenel Skendo, Dilaver



Hamzaji, Hazsi Tola, Arif Osmani, Din Shtëmbari, Luftar Cako, e Ytvi Veliu dhe ushtarë gjermanë të kapur rob të cilët kontribuan e dhanë jetën dhe për këta nuk ka sot një pllakë apo lapidar në këtë zonë të cilët e vizitojnë mijëra turistë të huaj.

Në provokacionet greke të gushtit 1949 trupat xheniere e të tjera hapën mbi 20 kilometra trashnshe dhe e elementë tjerë që penguan veprimet e ushtrisë greke. Për veprimet e kryera nga trupa xheniere kanë shkruar e folur oficerë të nderuar xheniere si: Veli Dedi, Mendu Baca, Alfred Moisiu, Nexhmi Menzelxhi, Abedin Galanxhi, Ramiz Fiçorri, Kosta Panajoti, Miti Gollosi, Thimi Lapi, Bujar Mancellari, Saba Bushi, Abil Zerhani, Besnik Alibali, Lulëzim Salilari, Thoma Vaso Dedë Prenga, Vasil Premçi e shumë të tjerë. Trupat Xheniere Shqiptare e kanë treguar veten si një domosdoshmeri e përfqësuese e denjë e popullit e FASH në vepra praktike që janë sot histori e gjallë.

Nuk ka copë toke, rruge, mali fushe, uji e kodra ku nuk ka punuar dhe kontribuar Xhenio me oficarë

civilë ushtarë aktive e rezerviste të Shqipërisë në vite, pavarësisht kush ka qënë në pushtet. Detyrat tona kanë qënë dhe janë më se humane në interes të komunitetit.

Nga Saranda, Përmeti, Himara, Puka, Vlora, Kukësi, Korça, Fieri, Vlora, Durrsi, Shkodra e Burreli, Progonati e Martaneshi, Librazhdi, e Sazani janë kryer aktivitetet e për-bashkta të FASH me trupat xheniere dhe njësitë e tjera ushtarake.

Tregues shumë real në komunitet për emergjencat civile është ndërhyrja energjike në raste permbytjesh, hapje rrugësh e në detyra shumë të rëndësishme drejtimi e zbatimi. Jemi krenarë për arritjet dhe nivelin e këtyre kuadrove e trupave xheniere.

Krenohemi me rrugën e gjatë dhe të vështirë, me sakrificë e me gjak. Krenohemi me heronjtë e Popullit: Xhemal Kada, Veli Dedi, e Shyqyri Alimerko, me Heroin e Punës, Mendu Baca me dhjetra gjeneralë, kolonelë e shumë të tjerë me nivele dhe grada të larta, të cilët e kanë fituar më djersë dhe rezultate konkretet emrin e nderuar të xhenierit. Kemi me qindra inxhinierë të

cilët sot po e tregojnë veten për nivelin e tyre drejtues në fushën e ndërtimit.

Në këtë 104 vjetor të Armës së Xhenios krenohemi me xhenierin e nderuar 95 vjeçar, Dr. Alfred Moisiun që arriti deri në nivelin e Kryetarit të Shtetit si President i Republikës Shqipërisë, duke mbetur më i nderuarai e i respektuarai drejtues shteti pas viteve 1990.

Trupat xheniere nga vitet 1960-1985 kanë lozur rolin kryesor në sigurinë e mbrojtjes, përgatitjen e veprimeve mbrojtëse, nga ndërtimi i objekteve fortifikuese si një domosdoshmëri e pajustificueshme në periudhën e Luftës Ftohtë në ato vite. Sot objektet fortifikuese të shqipërisë janë vlerësuar në radhën e tretë nga studiues të huaj për cilesinë dhe sigurinë e tyre, si PZ, QZ, objekte si Gjadri, Porto-Palermo, Kuçova, Shengjini, Uzinat Ushtarake, sterhimet e popullates, të drejtim, komandimit, të cilat i kanë të gjithë vendet e zhvilluara në Perëndim e Lindje dhe në ditët e sotme kanë shtuar masat buxhetore për ndërtimin e të jerave me zgjerimin e prodhimit të armëve të reja më të sistikuara.

Pas viteve 1990 trupat xheniere përkrahën reformat e kryen me qindëra misione për komunitetin, nga ujësjellësi i Shupenzës (viti 1994), rruga e Astirit, Fshati, Bathore etj. Ato kanë riparuar dhe ndërtuar qindra ura e rrugë në gjithë territorin e shqipërisë. Kjo është e do jetë arma e xhnios dhe duhet vlerësuar e respektuar nga secila qeveri ndër vite jashtë politikës. Ne sot kujtojmë me respekte mbi 160 dëshmorë dhe të rënë në krye detyrës dhe qindra të plagosur e gjymtuar nga puna, nga minat e municionet nga viti 1936 e deri të ngjarjet shkatërruese vitit 1997.

Po ashtu marrja pjesë në pastrimin e 15 zonave të cialt u infektuan nga shpërthimet e depove në vitin 1997, në pastrimin e zonës kufitare Kukës e Tropojë nga minat bombletë që hodhi ushtria serbe në vitin 1999 gjatë spastrimit etnik të popullksisë kosvare.

Punën, veprën, aktivitetin, sakrificat, individuale dhe ato familjare i vlerëson populli, i respektojnë edhe organizmat e huaja, pasi strukturat e shtetit, veçanërisht pas 1990 e kërkonin xhenion kur kishte përmbytje, emergjenca, zjarre, rrezim urash apo tërmete.

Historia e armës xhenios po merr formë me shkrime me kujtime të ndryshme ndër vite në këtë 104 vjetor dhe me dëshira individuale e jo instucionale, me të dhëna për të njohur e treguar konkretisht dhe për të mbetur Arma e Xhenios e betonuar në themelet e betonta të Shqipërisë.

\* Ish ushtar dhe oficer në armën e xhenios nga viti 1967 dhe deri në fillimin e vitit të 75 të ditëlindjes

## SUPLEMENTI LETRAT



Sakip Cami

www.ljalaelire.com

Revista "Albanian Post" Britani e Madhe

## Nga Sakip Cami

Kur lexova librin me kujtime të Rosela Jakut Kodrës "Gjurmët e gjyshes në zemrën time" u emocionova shumë. Kujtimet e saj ngjasonin me kujtimet e mija për gjyshen Pemë, me kujtimet e Loretës për gjyshen Razië, me kujtimet e Redit për gjyshe Nazën. Ne që jemi rritur me gjyshe e ndiejmë forcën dhe emocionin e këtij libri, por jo vetëm ne. Ky është ngjasimi sepse dashuria e gjyshes për mbesën dhe nipin është hyjnore, sa e përgjithshme aq dhe e veçantë.

□ I ëmbël zëri i gjyshes/kur ngjarje më tregon/e lehtë dora e saja/kur ëmbël më ledhaton/....Kjo këngë e Agim Krajkës, kënduar nga Vaçe Zela më ka shoqëruar edhe mua gjithmonë.

□ Më ka shoqëruar edhe ninulla e gjyshes time, nëna Nexhit siç i thirrja unë, shkruan autorja.

□ A ka këngë më të bukur në botë se sa ninulla e nënave ???

Fëmijëria ime me gjyshen ishte një periudhë e shkurtër, por e mbushur me kujtime të çmuara. Kështu e nis Rosela librin e saj me kujtime për gjyshen.

...Për mua ishte gjithmonë ajo që mbante shtëpinë të ngrohtë dhe zemrën të hapur. Deri në moshën pesëvjeçare timen, ajo ishte pranë meje çdo ditë. Një prani e ngrohtë dhe e sigurtë që më përkëdhelte me dashurinë e saj të pamasë. Kur ajo u largua për në Greqi në vitin 2001 për të punuar e jetuar me gjyshin, ndjeva mungesën e saj, ndjeva një boshllëk të madh. Por as largësia nuk na ndau. Pothuajse çdo ditë flisnim në telefon, dhe zëri i saj ishte si një urë që na lidhte, duke më dhënë gjithmonë ndjesinë se ajo ishte aty, me mua. Nuk na munguan asnjëherë as kartolinat me urimet e fundvitit që gjyshja dhe gjyshi na dërgonin çdo vit. Kartolinat e tyre ishin si një përqafim nga larg, dhe çdo fundvit mbushnin shtëpinë tonë me ngrohtësi dhe gëzim. Gjithashtu, dhuratat që na dërgonin nga Greqia ishin një

moment i veçantë. Mbjaj mend emocionin dhe padurimin kur prisnim ato çanta të mbushura me dashuri. Sa here që hapim një dhuratë, ndiheshim sikur ajo ishte pranë nesh. Kur isha në shkollë fillore, gjyshi dhe gjyshja më sillnin nga Greqia mjete shkolle që ishin ndryshe nga çdo gjë tjetër që kisha pare. Çanta, kuleta, lapsa, fletore dhe ngjyra – gjithçka ishte kaq e bukur dhe e veçantë. Nuk mund ta harroj krenarinë që ndjeja kur shkoja në shkollë me ato gjëra. Ndoshta isha fëmija me mjetet më të bukura në klasë, dhe të gjitha ato dhurata ishin një kujtesë e dashurisë së pakushtëzuar të gjyshërve për mua.

Megjithëse takimet tona ishin të rralla pas ikjes në Greqi, çdo here që ajo vinte në Shqipëri, përjetonim momente të paharrueshme. Ajo na përqafonte fort dhe na rrëfente për gjithçka që kishte bërë ndërkohë. Ato vite që kaloi atje, ishin vite të vështira për të, të mbushura me sakrificë, lodhje dhe përpjekje të pafundme për të siguruar gjithçka që kishin nevojë. Gjyshja gjithmonë thoshte se e gjithë puna dhe lodhja e saj ia vlente. Kjo e bënte edhe më të veçantë dhe më të shtrenjtë dashurinë time për të.

Kur unë isha rreth gjashtëmbëdhjetë - shtatëmbëdhjetë vjeç, gjyshi dhe gjyshja u kthyen përfundimisht në Shqipëri. Jeta jonë ndryshoi sërish. Ishte sikur një pjesë e munguar e familjes sonë më në fund të ishte rikthyer. E gjeta veten gjithnjë e më shpesh në shtëpinë e tyre. Ajo shtëpi ishte si një strehë e sigurt dhe një vend që mbushte shpirtin tim me ngrohtësi. Ndiheha më e qetë dhe më e përmbyshur pranë gjyshes, e cila vazhdonte të më përkëdhelte me dashurinë dhe kujdesin e saj. Prindërit e mi shpesh më thoshin: "Duket sikur shtëpia jonë nuk është më shtëpia jote!" Dhe ndoshta kishin të drejtë, sepse zemra ime ndodhej gjithmonë pranë gjyshes dhe gjyshit.

Gjyshja u bë shoqja ime më e mire, një dëgjuese e palodhur dhe një këshilluese që gjithmonë kishte përgjigjen e duhur. Ajo dinte gjithçka për mua, madje edhe

*Libër i thjeshtë, i shkurtër, mbushur me ndjesi e kujtime - një thirrje për kohën që jetojmë*

## Rosela Jaku Kodra dhe libri i saj për gjyshen

- *Këtë libër me kujtime autorja e re që sprovon vehten për herë të parë ja kushton gjyshes së saj Nexhmie Cami Rama. Libri vjen nën redaktimin e Prof Shpëtim Camit dhe nën kujdesin e Shtëpisë Botuese "GEER"*

ato që nuk ia tregojnë mamit, motrës apo shoqeve të mia. Mes nesh nuk kishte sekrete, vetëm besim të ndërsjelltë dhe dashuri të pakushtëzuar. Çdo bisedë me të më bënte të ndihem e lehtësuar dhe e kuptuar, ishte një mësim i ri, një fjalë e ngrohtë ose një premtim që gjithçka do të shkonte mire.

E mbaj mend si tani, netët kur qëndroja me të dhe më tregonte histori nga rinia e saj. Ajo më fliste për kohët e vështira, për sakrificat që kishte bërë për familjen dhe për kënaqësin që gjente në gjithçka që bënte për ne. Tregimet e saj ishin plot ngjyra dhe mësim, dhe shpesh përfundonin me një këshillë të urtë: "Mbjaj mend, zemra e nënës, jeta është e vështirë, por nëse punon fort dhe respekton veten, do të arrish gjithçka."

### E PAHARRUAR AROMA E GATIMEVE TË SAJ

Kuzhina e gjyshes ishte një botë më vete, plot dashuri dhe shije të përsëritshme. I jepje shumë rëndësi çdo vakti të ditës, dhe tavolina e saj ishte gjithmonë plot me shumëllojshmëri të mrekullueshme. Kujtoj ende aromën e gatimeve të saj që përhapej në të gjithë shtëpinë dhe tërhiqte këdo drejt tavolinës.

Omletat që bënte ishin të veçanta, asnjëherë nuk i kam provuar të njëjtat. Kekët e saj ishin një mrekulli më vete, me shije unike që i bënin të paharrueshëm.

Byrekët e holluar me dorë, petullat e buta dhe të shijshme, tavat e ndryshme në furrë, e reçelat që përgatiste me aq dashuri. Sallata e frutave që e përgatiste përditë ishin pjesë e çdo vakti. Pastaj vinin ëmbëlsirat e saj, të cilat ishin thjeshtë të pakrahasueshme: qumështori i butë, ashurja e ëmbël, sultjashi me aromë kanellë, dhe shumë të tjera që vetëm ajo dinte t'i përgatiste me një shije kaq të veçantë. Dhe mbi të gjitha, një nga traditat që nuk harrohet dhe që do të na mungojë gjithmonë, ishte atmosfera e veçantë kur vinte Dita e Verës. Gjyshja gjithmonë përgatiste vezët e ngjyrosura plot ngjyra të bukura, veroret që i thurte me shumë kujdes dhe kulaçin e shijshëm me një monedhë brënda. Të gjithë prisnim me padurim të shijonim kulaçin dhe të gjenim monedhën, një simbol i fatit dhe lumturisë që ajo na uronte. Ishte një ritual që e përsëriste çdo vit dhe që mbushte shtëpinë me gëzim dhe traditë. Sa herë shkoja për të qëndruar te shtëpia e tyre, gjyshja gjithmonë më pyeste: "Çfarë ke qejf të të gatuaj?" Dhe pa përgjigje, përgatiste gjithmonë ato që unë pëlqoja më shumë. Duart e saj të arta dhe dashuria që fuste në çdo gatim e bënin çdo ushqim një kënaqësi të veçantë. Disa nga këto receta dhe sekrete të kuzhinës m'i mësoi edhe mua. Sot, përpiqem t'i ndjek, por e di që shijen e duarve të saj nuk do ta arrij dot kurrë. Do të doja shumë që të isha po aq e zonja në kuzhinë sa ajo, sepse gjyshja ime ishte një mjeshtrë e vërtet e

gatimit, njësoj siç ishte përçuese edhe e dashurisë dhe përkujdesjes.

Çdo moment me gjyshen time ishte një kujtim i bukur, një copëz lumturie e ruajtur në zemrën time. Me të nuk kishte momente të trishtuara, vetëm gëzim, dashuri dhe ngrohtësi. Gjyshja kishte një aftësi të rrallë për të bërë çdo ditë të veçantë, qoftë edhe me gjërat më të vogla. Më kujtohet se sa shumë qeshnim bashkë. Bisedat tona ishin të pafundme, nga gjërat më të thjeshta të përditshme deri tek këshillat e saj të urta për jetën. Mund ti tregojnë gjithçka, dhe ajo më dëgjonte me kujdes, pa më gjykuar kurrë. Ishte personi im i parë për çdo gëzim dhe për çdo shqetësim.

Pushimet që kalonim së bashku ishin nga më të bukurat. Mbjaj mend sa shumë më lumturonte thjesht fakti që e kisha pranë. Kujtoj me mall udhëtimet tona të vogla, shëtitjet, kafet që dilnim shpesh së bashku, pazaret e përbashkëta. Një ndër kujtimet më të bukura dhe të paharrueshme është koha kur ata jetonin në Greqi, dhe unë shkoja së bashku me motrën time për pushimet verore. Dy muaj që kalonim atje ishin gjithmonë magjikë, të mbushura me gëzim dhe aventura të pafundme. Ishin verat më të bukura të jetës sime, të cilat kujtoj me mall dhe nostalgji. Çdo ditë kishte një ritëm të veçantë. Dilnim të gjithë së bashku, shkonim në plazh dhe shijonim ujën e kristaltë, vizitonim qytetin dhe eksploronim rrugicat e tij. Më kujtohet gjallëria e atyre ditëve, qeshjet, bisedat dhe momentet e vogla që i bënin të mëdha kujtimet tona.

Gjatë udhëtimit tona, makina jonë nuk ishte thjesht një mjet transporti, por një vend i mbushur me biseda të gjata, të qeshura dhe këngë. Gjyshja gjithmonë përgatiste ushqim për rrugën, duke mos ardhur kurrë duarbosh. Më kujtohen gjithashtu kafet buzë detit me të dhe gjyshin, ishin çaste qetësie dhe lumturie të pastër. Festat ishin gjithmonë të mbushura me dashurinë e tyre. Për 8 Marsin, çdo vit e surprizoja me një buqetë lulësh dhe me një kartolinë, dhe së bashku me mamin dhe motrën dilnim për drekë. Ditëlindjet e saj, të miat dhe të gjithë familjarëve, ishin gjithmonë një arsyë për t'u mbledhur bashkë. Ata nuk mungonin kurrë në asnjë festë apo sepep familjar. Një tjetër çast lumturie që dua të kujtoj është një nga udhëtimet që bëmë së bashku me gjyshin, tezen dhe gocën e tezes. Kësaj here shkuam në Itali, Gjermani dhe Hollandë. Ishin ditë të paharrueshme dhe të mbushura me lumturi. Shëtitëm çdo vend dhe rrugicë të atyre vëndeve, duke shijuar bukurinë dhe magjinë e tyre. Pimë kafe së bashku, hëngrëm dreka të shijshme dhe eksporuam dyqane të ndryshme. Çdo moment ishte një kënaqësi më vete. Qeshëm pafund dhe u

(Vijon në faqen 14)

## SUPLEMENTI LETRAT

## Rosela Jaku Kodra dhe libri i saj për gjyshen

(Cijon nga faqja 13)

argëtuam sikur nuk kishte të nesërme. Ato ditë mbetën ndër kujtimet më të bukura dhe argëtuese për të gjithë ne.

## KËSHILLTARJA MË E MIRË PËR JETËN

Një ndër momentet më të bukura, jo vetëm për mua, por edhe për gjyshen dhe gjyshin, ishte koha kur u martova dhe nisa një jetë të re me bashkëshortin tim. Lumturia e tyre nuk kishte kufi kur mësuam se shtëpia ime do të ishte pranë shtëpisë së tyre. “E shikoni sa fort ju dua dhe më doni? Fati im ishte shkruar që unë të jetoja pranë jush!”, u thashë me entuziazëm. Ata qeshën, më përqaftuan fort dhe ndjeva se nuk kishte gjë më të bukur se të isha pranë tyre çdo ditë.

Kjo afërsi e forcoi edhe më shumë marrëdhënien tonë, duke na bërë të pandashëm. Nuk kishte ditë që të mos takoheshim, që të mos ndanim një kafe së bashku apo një bisedë të ngrohtë. Çdo mëngjes, para se të fillonim ditën, uleshim dhe pinim kafën bashkë, duke biseduar për gjithçka, duke qeshur dhe duke ndarë mendime. Nuk ishte thjeshtë një rutinë, ishte një moment i shenjtë, një ritëm i ditës që na mbante të lidhur edhe më fort. Por ajo nuk mjaftohej vetëm me kaq. Vinte shpesh në shtëpinë time për të më ndihmuar me gjithçka që kisha nevojë. Ajo nuk e njihte fjalën “lodhje”, përkundrazi gjithmonë kërkonte të bënte diçka për mua. Po ashtu, unë shkoja shpesh në shtëpinë e saj, duke e ndihmuar, duke kaluar kohë me të dhe duke u kujdesur që të mos i mungonte asgjë. Nuk kishte ditë që të mos ishim bashkë. Ato ishin vite të mbushura me dashuri, me kujdes të ndërsjelltë dhe me momente të bukura që do t'i ruaj në zemër përgjithmonë. Ky ishte një nga bekimet më të mëdha të jetës sime, të jem pranë gjyshes dhe gjyshit tim, të ndaj çdo ditë me ta, dhe të shijoj lumturinë e thjeshtë të të pasurit pranë njerëzit që doja më shumë në botë.

Dhe sigurisht, kujtimi më i çmuar dhe më i ndjerë për të ishte kur unë linda dhe u bëra nënë për here të parë. Për gjyshen, kjo ishte një nga gëzimet më të mëdha të jetës së saj. Ajo e priti me emocione të papërshkrueshme ardhjen e djalit tim në jetë. Që nga momenti i parë, ajo u bë jo vetëm stërgjyshe e përkushtuar, por edhe një strehë e sigurt për djalin tim. Çdo ditë që ajo kalonte me djalin tim ishte një dhuratë. Ajo e ushqente, e vinte në gjumë, i këndonte ninulla dhe e mbante në krahët e saj me gjithë dashurinë e botës. Ishte e mrekullueshme ta shihja se si për të, ky vogëlsh ishte një burim i pashtershëm lumturie dhe force. Në sytë e saj lexoja krenarinë dhe gëzimin sa here që shihte djalin tim duke qeshur apo duke hedhur hapat e tij të parë. Për të, ai ishte një dritë e re në familje, një arsye më shumë për të buzëqeshur dhe për të vazhduar përpara, edhe kur vitet po rëndonin mbi supet e saj. Ishte lumturia e saj më e madhe dhe kjo lidhje e tyre ishte një nga gjërat më të bukura që kam përjetuar ndonjëherë. Kujdesi i saj për të ishte i pafund, dhe merak i saj më i madh ishte gjithmonë ai. Nuk kishte ditë që të mos më thoshte: “Aman, shiko djalin! Si është djali? Kujdes djalin!” Ishte gjithmonë me mendjen tek ai. Djali dhe gjyshja krijuan një lidhje kaq të fortë. Unë shkoja çdo ditë tek shtëpia e tyre për të kaluar kohë me ta, dhe djalin e merrja gjithmonë me vete. Sa here që ngjiteshim shkallëve të pallatit, ai thërriste me dashuri: “Nëna Nexhi, Gjyshi Vetë” dhe mezi priste ti shikonte. Ajo e priste gjithmonë me krahë hapur, me një buzëqeshje më të sinqert që mund të ekzistonte. Në sytë e saj shihja lumturinë absolute kur luante me të, kur e mbante në prehër dhe kur i tregonte përralla. Ai e donte aq shumë, sa kur e pyesja: “Kë do më shumë, nënën apo gjyshin?”, ai përgjigjej me sinqeritetin më

të ëmbël: “Nënën...pak më shumë!” Ishte një dashuri e pastër, një lidhje e pakrahësueshme mes një fëmije dhe një stërgjysheje që i fali gjithçka nga vetja. Gjyshja nuk ishte vetëm një burim dashurie, por edhe një njeri duarartë. Unë kam kaq shumë kujtime të bukura nga gjërat që ajo qepte dhe qëndiste me dorë për mua dhe për djalin tim. Trikot, palçetat, kapuç dhe papuçet e leshit, të gjitha të punuara me përkujdesje dhe dashuri të pakufishme. Sa here që e shikoja duke punuar me dorë, duke thurur me aq përkushtim dhe duke zgjedhur me kujdes çdo fije peri, e dija që ajo nuk po qepte vetëm rroba, ajo po krijonte kujtime, po na linte një pjesë të shpirtit të saj.

Një nga momentet më të bukura dhe më të rëndësishme që mbyll kapitullin e kujtimeve tona të lumtura me gjyshen, është udhëtimi ynë i fundit së bashku. Ishte gushti i vitit 2024, dhe vendosëm të bënim një udhëtim familjar në Voskopojë, Korçë dhe Pogradec. Gjyshja kishte shumë dëshirë të shkonte në ato vende, pasi kishin kaluar shumë vite të tëra që nga vizita e saj e fundit. Shkuam të gjithë së bashku, unë mami, djali, gjyshi dhe gjyshja. Ishte një udhëtim i veçantë, plot emocione dhe gëzim. Vizitua çdo vënd, ecëm në çdo rrugicë të atyre qyteteve të bukura, duke shijuar atmosferën e tyre të qetë dhe magjike. Nga mëngjesi deri në darkë, gjithçka ishte e mbushur me momente të ngrohta familjare. Mëngjeset i kalonim në ato kafenetë tradicionale, ku gjyshja shijonte një filxhan kafeje me një buzëqeshje të qetë në fytyrë. Dreka e darka ishin plot me shije të veçanta dhe biseda të këndshme. Nuk munguan as fotografitë, bëmë pafund foto për të fiksuar çdo moment të atyre ditëve të mrekullueshme. Ishte një udhëtim që i dhuroi gjyshes shumë gëzim dhe që për ne mbeti si një kujtim i çmuar. Në ato dy ditë, ajo ishte plot energji dhe lumturi, duke shijuar çdo çast sikur të ishte një nga aventurat tona të dikurshme. Nuk e dinim atëherë se ky do të ishte udhëtimi ynë i fundit së bashku, por e di me siguri që ajo e shijoi me gjithë zemër. Dhe unë do ta ruaj atë kujtim gjithmonë si një nga më të bukurit e jetës sime.

Sot, mungesa e saj ndihet thellë në çdo detaj të jetës sime. Ende e ndjej praninë e saj në kujtime, në shijet e ushqimeve që më mësoi, në këshillat e saj të urta që më udhëheqin çdo ditë. Do të doja të mund ta përqafoja edhe një herë, të kaloja edhe një ditë me të, të ndaja edhe një vakt të gatuar nga duart e saj të arta. Por ndonëse nuk është fizikisht, ajo do të jetojë gjithmonë në zemrën time, në çdo kujtim, moment lumturie që më ka dhuruar.

## “MËSO, BËHU E ZONJA E VETES!”


Kjo ishte një nga këshillat e saj më të shpeshta. Ajo i jepte shumë rëndësi shkollimit dhe punës. Më tregonte për mundimet e saj, për sakrificat që kishte bërë për të pasur një jetë më të mirë dhe më thoshte gjithmonë: “Mos u mbështet tek askush, puno, lufto dhe fito me forcat e tua. Njeriu që di dhe punon, nuk ka frikë nga asgjë.”

“Gjithmonë bëj të mirën!” - Gjyshja më mësoi se e mira nuk humbet kurrë, edhe kur nuk te kthehet menjëherë. Ajo ishte një grua që ndihmonte gjithkënd pa pritje asgjë në këmbim. “Zemra e mirë është pasuria më e madhe që mund të kesh në jetë,” më thoshte shpesh.

“Mos u anko, përballo gjithçka me forcë dhe buzëqeshje!” - Edhe kur ishte e sëmurë, edhe kur lodhja e viteve rëndonte mbi të, ajo nuk u ankua kurrë. “Jeta është sfidë, por ti nuk duhet të dorëzohesh. Përballoje me forcë dhe mos e humb kurrë buzëqeshjen,” më këshillonte gjithmonë.

“Familja është gjithçka!” - Ajo më mësoi se sado e madhe të jetë jeta, sado larg të shkosh, sado e suksesshme të bëhesh, familja është dhe do të mbetet gjithmonë streha me e ngrohtë. Ajo jetonte për familjen, për ne, dhe kjo ishte një nga mësimet më të çmuara që më dha.

“Jeto çdo moment dhe shijojë jetën!” - Ndonëse kishte kaluar shumë sfida,



gjyshja dinte ta shijonte jetën. Ajo më mësoi të mos e harroj kurrë rëndësinë e momenteve të bukura, të mos e lë jetën të më kalojë pa e vlerësuar çdo ditë që më është dhuruar.

“Kujdesu për veten, mos e lër pas dore!” - Një këshillë që më përsëriste shpesh ishte që të kujdesesha për veten, për shëndetin, për paraqitjen dhe për mirëqenien time. “Gruaja duhet ta mbajë veten gjithmonë të pastër, të rregullt dhe të kujdesur, sepse nëse nuk kujdesesh për veten tënde, nuk mund të kujdesesh siç duhet për të tjerët,” më thoshte me dashuri.

## “JE E ZONJA DHE E SHKATHËT, SI UNË!”

Një nga gjërat që i pëlqente më së shumti tek unë ishte fakti që isha e zonja, e shkathët dhe e aftë për gjithçka. E gjithmonë më thoshte me krenari: “Për këtë më ke ngjarë mua!” Kjo më bënte të ndihesha mirë, sepse ajo ishte modeli im i forcës dhe përkushtimit.

“Duhet të mësosh të jesh më e qetë!” - Një nga gjërat që ajo dëshironte që unë ta përmirësoja ishte mënyra se si reagoja në situata të ndryshme. E dinte që nxehtëm shpejt dhe shpesh tonaliteti im bëhej më i lartë seç duhej. “Me qetësi, me butësi dhe pak diplomaci, gjithmonë del e nderuar në çdo situatë,” më thoshte. Ajo kishte një mënyrë të veçantë për të komunikuar, e qetë, e urtë, dhe gjithmonë e zgjuar në fjalë. Donte që dhe unë ta mësoja këtë aftësi. “Pastërtia dhe rregullt janë gjysma e punës!” - Një punë e bërë me rregull dhe pastërti është gjysma e suksesit,” më thoshte, duke më mësuar çdo detaj për mirëmbajtjen e shtëpisë dhe gatimin e shijshëm. Këto nuk ishin thjesht fjalë, por udhëzime për jetën, mësimet që do të më

shoqërojnë gjithmonë. Zëri i saj, këshillat e saj dhe shembulli i saj do të mbeten të paharrueshme. Ajo jo vetëm më tregoi si të eci përpara, por më mësoi edhe si të jem një njeri i mirë, e drejtë dhe me vlera. Dhe për këtë, do t'i jem mirënjohëse gjithmonë.

## TI PËRGATITIM FËMIJËT PËR JETËN ME VLERAT MË TË MIRA FAMILJARE DHE SHOQËRORE

Gjyshja ime ishte dhe do të mbetet gjithmonë pjesë e pandashme e jetës sime. Çdo fjalë, çdo këshillë dhe çdo moment që ndamë bashkë janë të ngulitura thellë në zemrën time.

Mungesa e saj ndihet në çdo hap, por kujtimet e saj janë një ngushëllim i madh. Çdo herë që ndjej nevojën për të, e di që ajo është ende me mua - në zemrën time, në fjalët e saj të mençura dhe në dashurinë që na ka lënë pas.

Ky libër është për të, por edhe për ne - për të ruajtur kujtimet e saj të paharrueshme dhe për të kujtuar gjithmonë se sa me fat ishim që e kishim në jetën tonë. Ajo ishte dhe mbetet një dritë e pashuar që na ndriçon jetën.

Faleminderit, gjyshja ime, që ishe gjithçka për mua, për ne. Kështu e mbyll librin autorja Rosela Jaku Kodra. Ky libër i thjeshtë, i shkurtër, mbushur me ndjesi e kujtime reale është edhe një thirrje për kohën që jetojmë: “O njerëz, bota nuk është interneti dhe virtualiteti, bota është realiteti që jetojmë.”

Kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit është detyra njerëzore më e rëndësishme, është kabanë alarmi për shoqërinë e sotme.

Familja me të tre brezat e saj është baza e jetës.

## SUPLEMENTI LETRAT

Episodet e sjella me mjeshtëri dhe me magji nga dr. Neki Dredha, që i japin veprës letrare dinjitet dhe përjetësisht ngelën në histori

# Heronjtë e luftës partizane të Labërisë

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

## POEMË E SHKRUAR MË ATD-HETARIZËM

Poema është shkruar me frymëzim nga autori i cili e njeh dhe e zotëron mjaft mirë dhe bukur filozofinë dhe kulturën e një populli trim dhe bujar të Konisë së hershme dhe të Labërisë së sotme. Të gjitha figurat luftarake, vendet historike, këngët magjepse labe, historitë e pafundme të Labërisë, janë trajtura me dashuri dhe ndjenjë të brendshme nga autori, i cili i ka studiuar dhe njohur thellë të gjitha dhe ivendosur në vendin e duhur siç natyra ka vendosur si në penel magjinë e kësaj krahinë magjike, të lartësuar në shekuj, si bedenat e kalave që mban në gjirin e saj.

Autori në këngën XX na përshkruan kohë të reja dhe heronj të rinj për Labërinë. Në këtë këngë autori heroin e nxjerr nga kënga labe, e cila vjen e ngazëllyer "për trimoshat zemërshkabë". Shikimin autori e hedhur lart në qiell dhe shikon yjet, të cilët duken sikur shuhen, por nuk kanë të shuar në qiellin e pafund dhe ndriçojnë më fuqishëm në histori.

Në poemë autori si një ushtarak i mifrëfilltë e ka hedhur shikimin tek një aleat i përhershëm dhe i sigurt i trimave që është mali. Terreni sipas ushtarakëve është njëri nga tre elementët e luftës, dhe si i tillë ai i ka qëndruar besnik labit në shekuj. Në një strofë të poemës përzihet një histori e tërë luftërash dhe betejash, sepse bijtë e Ismail Qemalit i dolën zot vatanit me flamurin e Skënderbeut. Nëpërmjet katër yjeve që rrezatojnë dritë, autori ka çarë terrin dhe bije para publikut madhështinë dhe heroizmin e Mynyr Xhindit, Ramize Gjebresë, Zaho Kokës dhe Fejzo Gjomema.



## MYNYR XHINDI, YLLI QË RREZATON DRITË

Djaloshi Mynyr Arshi Xhindi e nisi rrugëtimin e tij antifashist në fshatin e lindjes Drashovicë dhe përshkroi gjithë Labërinë, në tëndat dhe stanet labe, në gërshet ku labi me shpirt ndër dhembë, i qëndronte besnik traditës dhe jetës. Autori e përshkruan trimin sypatrembur në tufane, që në çdo derë të Labërisë që trokiti zgjoi Toskërinë dhe e ngriti në këmbë për luftën vigane.

Djemtë e Labërisë kur dëgjuan zhurmë baroti, si Mynyr Xhindi ju ndez gjaku, ju terr mendja dhe ngriti Toskërinë në këmbë. Për labër fjalë e tij ishte mjalt, sjellja e tij ishte fisnike, sepse ishte fisnik nga gjaku. Nuk kanë të përshkruar vargjet e gdhendura në shkëmb për të, kur poeti shprehte për Mynyrin "te çdo zemër Kaonie, / ndezi zjarrin e lirisë".

Mynyr Xhindi u zgjodh sekretar organizativ i Qarkorit të Partisë Komuniste për Vlorën. Më parë kishte qenë anëtar i Grupit Komunist të Shkodrës, si dhe shok e bashkëluftëtar në vitet e shkollimit me Qemal Stafën. Pushtimi fashist i Shqipërisë, bëri që mjaft të rinj antifashistë, idealistë e atdhetarë të kohës, të braktisnin studimet, siç bëri edhe Mynyri i cil la studimet në mes të inxhinierisë në Grenoble të Francës dhe u kthye në Atdhe. Ai u përfshi në organizimin e rezistencës antifashiste.

E nisi luftën në qytetin e Vlorës për të vijuar në fshatrat e Lumit të Vlorës, ngjalli shpresë dhe bashkoi "plumbat të shporrej armiku".



dr. Neki Dredha

• Në poemën "Labëria magjike" të autorit dr. Neki Dredha, shpaloset si pala e Flamurit Kombëtar historia dhe kënga, luftërat dhe vendet simbol, episode e personalitete të Labërisë në shekuj. Në këtë poemë autori ka derdhur shpirtin e tij, në shpirtin e Labërisë dhe ka përshkruar në çdo detaje një histori, një ngjarje, një figurë legjendë që i ka dhënë emër, emrit të ndritur të Labërisë

Ai ra në luftë më 4 nëntor 1943, në zemër të krahinës së Mesaplikut, në kohën e organizimit të BrVS. Rënia e tij, ishte tragjike dhe sipas dëshmitarëve të shumtë, antifashisti Mynyr Xhindi i shfaqte qëndrimet e tij hapur në radhët e komunistëve dhe në popull për Kosovën që ishte Shqipëri. Poeti e mbyll episodin për luftëtarin se "mbi krye të flamurit, / ndrijnë kurora dafine".

Ai është Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës.

E THANË GONXHEN ËNDËR-RORE

Për Ramize Gjebrenë në vite është folur dhe shkruar shumë. Ramize Rustem Gjebrea ka lindur më 20 prill 1923 në Gjirokastrë. Mbaroi Institutin "Nëna Mbretëreshë" në Tiranë dhe kreu studimet e larta në Itali. Më formimin e BrVS në Bramyshnjë të Tërbaçit u caktua përgjegjëse e rinisë në brigadë. Ajo mbante pseudonimin "Ramona". Ajo ishte oratore, fjalëzjarrtë, idealiste dhe antifashiste. Poeti me të drejtë e quan "ajkën e vajzërisë" U vra padrejtësisht nga gjyqi partizan në Ramicë. Brigada në Ramicë u rreshtua në Kruan e Hyse. Ajo eci krenare drejt shokëve dhe shoqeve të Brigadës, por më krenare drejt skuadrës së pushkatimit, që siç shkruan poeti eci në luftën partizane me "shpirtin vrullor". Në këtë luftë të shenjtë ajo "zgjoi ndjenjat trimërore", dhe çdo partizane të brigadës i la si kujtim "heroizmin labëror".

Gjuha e Ramizesë ishte frymëzuese, ishte "gjuhë borizani". Kudo fjala e saj ishte zjarr dhe ëmbëlsi për va-

zjat dhe gratë që po mushnin radhët partizane në brigadat sulmuese. Dhe poeti Neki Dredha, e përshkruan portretin e kësaj luftëtarje të kohës se "te çdo zemër partizani" Ramizeja ju "mëkoi bindjen për Liri". Ra në luftë Ramizeja nga një dorë vrastare që hante bukën partizane të popullit dhe bënte lojën e armikut. Kur po festohej me madhësi fitorja nga operacioni i dimrit 1944, ndodhi dhe tragjedia. Shtabi i BrVS që komandoi me sukses e mundi shtabet naziste të një ushtrie të rregullt, bëri një "trimëri" të ultë, një pushkatim që prishi jehonën e fitores. Vranë udhëheqësit luanë të Vlorës një trimëreshë, një ëngjell ... Mbi varrin e saj në Ramicë nga 6 marsi 1944 pati lule të freskëta në çdo kohë, deri sa e morën prej aty, pas çlirimit, nga fundi i vitit 1946. Që nga koha e luftës dhe deri më sot, Ramizenë populli e ka pasur në mendje dhe në zemër. Zëri i saj jehon ende në Ramicë, Smokthinë dhe në tërë Labërinë, ndaj dhe poeti me të drejtë i kushtoi vargje ligjërime për simbolikën e saj.

Ramize Gjebrea është Dëshmore e Atdheut me vendim nr. 65, datë 02.10.1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Gjirokastrës.

## ZAHO, ZEMRA E BREGDETIT

Poeti rreshton aktet e trimërisë të luftëtarëve të lirisë dhe arrin në përfundimin se në atë Luftën Legjendare, ishte pushka partizane që i çoi në ferr të gjithë armiqtë. Në këtë luftë u shqua dhe trimi Zaho Andon Koka, i lindur në vitin e Luftës së Vlorës më 1920, por që i tregoi oficerit të karabinierisë italiane, se ky vend ka përsëri zot, duke i hequr atij



Mynyr Arshi Xhindi

Ramize Rustem Gjebrea

Zaho Andon Koka

Fejzo Xhafer Gjomema

përfundimisht egërsinë dhe djallëzinë që përdorte kundër popullit të Bregdetit dhe ja nëmëroi në lule të ballit më 26 gusht 1942 në Vishë të Himarës.

Që me fillimin e lëvizjes u bë një nga shtyllat kryesore të saj në Bregdet dhe u bë një nga pionierët e Lëvizjes ANÇ në krahinën e Himarës. Kundërshtoi të shkonte ushtar dhe doli në mal partizan në vitin 1942. Në krye të njësitit që komandonte, kreu disa atentate dhe aksione të guximshme. Zhvilloi punë të gjërë propagandistike për mobilizimin e popullit të Bregdetit në luftë, duke fituar simpati e respekt në popull dhe në luftëtarët e lirisë. U caktua zëvendëskomisar batalioni në BrVS, kreu mjaft detyra të vështira politike e luftarake. Udhëheqësit e BrVS, Zaho Xhoni yllin e saj e poshtërua, e vranë moralisht e shpirtërisht, ju prish imazhi, ndaj ra duke luftuar kundër nazistëve gjermanë në fshatin e tij të lindjes, më 8 qershor 1944.

Poeti arrin deri aty sa aktin heroik të rënies e përshkruan një akt legjendë sa drejtuesit ushtarak të nazistëve "i la pa mend trimëria" e tij. Autori në pak rreshta jep frymën për të cilën ata luftonin, ku në sytë e çdo partizani "ndriçonte vetëm Liria".

Ai është Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës dhe nderuar me titullin Hero i Popullit.

## FEJZO, YLLI NË FLAMUR!

Fejzo Xhafer Gjomema lindi në Tragjas në vitin 1919. Mbaroi shkollën teknike "Hari Fufts" në Tiranë. Ai ishte inteligjent dhe zotëronte gjuhën angleze, frënge, italiane, gjermanet dhe spanjolle. Përfshihet në lëvizjen komuniste që në vitin 1935 dhe u bë pjesëtar i grupit komunist të të rinjve në Shkodër në vitin 1937.

Kur ende nuk kishte marrë formë organizimi i grupeve luftarake, në shkollën tregtare në Vlorë ishte një grup nismëtar, ku bënte pjesë dhe Fejzo Gjomema.

Gjomema punoi, këndoi me mandolinën e tij dhe luftoi kudo si në Tiranë, Vlorë, Mallakastër. U përfshi në Lëvizjen Nacionalçlirimtare si një nga udhëheqësit më aktive të Qarko-

(Vijon në faqen 15)

## SUPLEMENTI LETRAT

Mendime për librin në tre vëllime "Shtegtime nëpër atdhe" të Berat Luzhës


## NJË ENCIKLOPEDI NDRYSHE NGA BERAT LUZHA

Ismet Balaj

Në librin tre vëllimesh... "Shtegtime nëpër atdhe", Berat Luzha, i njohur si gazetar publicist, poet e politikan, synon që t'i japë lexuesit, njohuri për historinë e kulturën e popullit shqiptar të shumë vendbanimeve iliro - arbërore - shqiptare në Ballkanin Perëndimor, që nga hershmëria e deri në ditët tona. Deri tash autori ka mbaruar tri vëllime me 800 faqe dhe i ka botuar. Secili botim ka 111 "Shtegtime", a shkrime, tregime të vërteta, pra gjithësejt 333 vendbaime të hulumtuara, të studiuara dhe të sjella në këto tri vëllime.

Nga leximi i tyre del qartë synimi që i ka vënë autori vetës: Të bëjë gjurmime e studime serioze, duke hulumtuar, ku shqiptarët kanë qenë e janë autoktonë në trojet e veta prej lashtësisë e deri në ditët e sotme. Autori nuk është një regjistruer i thjeshtë, por ka punuar me përkushtim të lartë, përgjegjësi profesionale e ndërshtëri për të vërtetat që hulumton, i gjen e pa pasion e emocione, ia jep lexuesit qartë, thjeshtë, drejtpërdrejtë, hapur pa figuracione letrare që mund t'ia errësonin e veshtirësonin kuptimin.

Me një të lexuar, s'ke pse t'i rikthehesh përsëri, sepse e kupton shprejt se gjithçka është paraqitur qartë. Brenda çdo shkrimi ai ka bërë më të mirën e mundshme, duke sjellur shumë informacione me sa më pak fjalë. Shumica shkrimeve nuk kanë më shumë se dy faqe. Ka material dokumentar dhe fotografi më shumë se çdo enciklopedi. Natyrisht ka qenë e vështirë ngjeshja fort e materialit të zgjedhur dhe të vendosur në libër. Si një fill i kuq, e përshkon nga fillimi deri në fund çdo shkrim atdhedashuria e autorit, besnikëria ndaj të vërtetave që gjen e i shkruan e i boton. Kjo vjen edhe nga udhëtimet e autorit në këto vendbanime, që edhe pse pensionist, e jo fort mirë me shëndet, as pareli, por me mund e dëshirë tëmadhe shkon kudo nëpër këto vendbanime, duke qenë jo një vizitor i çfarëdoshëm, soditës, por si një bir i çdo trualli, se e don dhe e vëzhgon me kujdesin më të madh dhe me "laps në dorë" mban shënime për vendbanimet: fshatra, qytete e hapësira etnike shqiptare. Njëkohësisht ka shfrytëzuar edhe material dokumentar. Këto material e pasurojnë edhe më shumë përmbajtjen reale të çdo shkrimi.



Unë, si studiues e botues i disa libra, për ngjarje e figura historike, sidomos për rrethin e Pukës, Tropojës, Mirditës dhe Kosovës, kam konstatuar se më kanë shpëtuar të dhëna me vlerë, por që autori i "Shtegtimeve..." i ka gjetur dhe i ka sjellë në këtë botim. Kjo dëshmon se studimet në fushën e historisë, të gjeografisë, të kulturës nuk shtërrojnë kurrë. Prandaj edhe brezat që vijnë radhë pas radhë, kanë për detyrë të ta njohin sa më mirë trevën e tyre, sepse edhe kështu ndikojnë shumë në edukimin e dashurisë për atdheun. Dashuri e cila, këtë shekullin e njezetë është zbehur shumë nga trysnia e gjithanmshme se "Atdheu im është ku hammë mire e jetoj më mire..."

Autori i "Shtegtimeve nëpër Atdhe" është mjeshtër edhe i shprehjes së mendimeve me pak fjalë, shkurt e saktë. Qe në titull të jep mendimin se çka brenda shkrimi: "Fushë-Arësi, qyteza e varfër me pasuri të mëdha", "Gjirokastra e gurit dhe e Gjin Bueshpatës", "Bujani i kullave, i ngjarjeve e i figurave historike", "Vlora e Flamurit dhe e krenarisë Kombëtare", "Manastiri i Alfabetit dhe i masakrës mbi parinë shqiptare", etj. Libri ka fotografi të për-

zgjedhura në mënyrë që të sjellë edhe të veçantën edhe të përbashkëten që kanë vendanimet shqiptare në histori, në kulturë, në etnografi të vështruara në kohë e në hapësirë.

Ky libër që do të botohet në disa vëllime pasqyron vendbanimet shqiptare në një formë të re enciklopedik, duke përmbledhur dije nga disa lëmie të jetës. Dihet se enciklopedia shkruhet në bazë të fushave të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë, ose në bazë fjalori, duke i renditur ngjarjet, faktet e tj. në bazë të alfabetit. "Shtegtime nëpër Atdhe", shkruhet në bazë vendbanimi, zone a krahine.

Mendoj që çdo bibliotekë në rrethe e në çdo shkollë duhet ta kenë këtë libër ku përfshihet edhe vendbabimi përkatës. Është një pasuri e çmuar që mësuesit e shkollave duhet ta kenë për mesimet mbi vendlindjen.

Motivi i librit është "SHQIPËRI/ PËR TY NË LUFTË, / PËR TY NË LIRI, / PËRJETËSISHT. / PËR TY KURDO, / ME TY KUDO: / DJE, SOT, NESËR, / PAFUNDËSISHT...."

Dua të vë në dukje se Berat Luzha e quan me të drejtë veprën e tij "Shtegtime nëpër Atdhe" jo vetëm në

• Berat Luzha e quan me të drejtë veprën e tij "Shtegtime nëpër Atdhe" jo vetëm në dy shtetet, brënda kufijëve Shqipëri e Kosovë, që na kanë detyrar Fuqitë e Mëdha, por në gjithë hapësirën ku shqiptarët jetojnë në trojet e tyre të lashta në gjithë Ballkanin Perëndimor

dy shtetet, brënda kufijëve Shqipëri e Kosovë, që na kanë detyrar Fuqitë e Mëdha, por në gjithë hapësirën ku shqiptarët jetojnë në trojet e tyre të lashta në gjithë Ballkanin Perëndimor

Dy vëllimet e para botohen në kuadër të 70 vjetorin të lindjes, ndërsa vëllimi I tretë, u botua në dhjetor 2024. I uorj nga zemra të jetojë sa më mirë e sa më gjatë, duke arritur numrin treshifror me vite, me shëndet e gjithçka i duhet i shoqëruar nga familja (e shoqja) dhe 6 djem e vajza, shumë nipër e mbesa që të gjithë në Kosovë jetojnë e punojnë. Të ketë energji të mjaftueshme për ta vazhduar këtë vepër patriotike në shërbim të brezave të sotëm e të ardhshëm. Rrallë gjën familje në Ballkan që gjithë djem e vajza të martuar e me fëmijë jetojnë në atdheun e tyre pa u shkapërderdhur nëpër Europë e botë.

Autori që në rini të hershme i është bashkuar levizjeve patriotike për çlirim të Kosovës. Bashkë me Jakup Krasniqin e tj u kanë prirë demonstratat të studentëve të vitit 1981 me thirrjen: "Kosova Republikë" në Prishtinë dhe është dënuar me 12 vite burg, të cilin e kreu në Nish të Serbisë. Pas burgut vazhdoi veprimtarinë ilegale të Kosovës deri sa u formua UÇK-ja. Ai drejtoi "Agjensinë Kosova Pres" dhe "Radion Kosova e lirë" që informonin edhe publikun ndërkombehtar për qëndresën dhe luftën e popullit të Kosovës për çlirim nga pushtuesit serbë.

Pas luftës ishte për disa legjislatura Deputet i PD-së në Kuvendin e Kosovës.

Ka botuar vëllimin poetik: "Këngë Burgu, Këngë Lirie", Një shistori për Sul Dyrmishin" (monografi), si edhe ka përgatitur dhe ka botuar materialet e Agjensisë Kosova Pres e Radio Kosova e Lirë, në katër vëllime që arrijnë në 2200 faqe,

Në pension, tani në moshën 72 vjeçare, po vazhdon me vendosmëri për të shkruar dhe botuar për çdo vendbanim shqiptar në Ballkanin Perëndimor. Çdo javë shkruan dhe hedh në internet 1-3 artikuj të till të shoqëruar edhe me foto që plotësojnë edhe më mire përmbajtjen, idetë dhe mesazhet që përcjell. Pastë suksese në vazhdimësi.

Të tri vëllimet "Shtegtime nëpër Atdhe" kanë 800 faqe me format të madh 23X25cm me letër speciael dhe të gjitha faqet me ngjyra. Natyrisht në ato libra është derdhur mendimi, djersa e munda i tij, por botimin e kanë mundësuar firma që nuk duan të publikohen për thjeshtësi e modesti.

## Heronjtë e luftës partizane të Labërisë

(Vijon nga faqja 14)

rit Komunist të Vlorës dhe u zgjodh sekretar politik i krahinës së Dukatit. Lufta e Drashovicës e vitit 1943 ishte një luftë frontale që bëhej midis partizanëve dhe ushtrisë naziste të pushtimit. Ishte një betejë e vërtetë, e organizuar më së miri dhe e miratuar nga Shtabi i Përgjithshëm, të cilën e drejtoi Shtabi i Zonës së Parë Operative.

Edhe pse ishin esesët trupa të zgjedhur për luftën partizane, në Drashovicë, ata panë "të zitë e ullirit" ku u vranë dhe mbetën dumbicë, sipas poetit dhe trimëria partizane "kokën nga supet u hoqën".

Midis yjeve që ranë në Betejën e Drashovicës ishte dhe Fejzo Gjomema. Të gjithë sipas poetit ishin yje e "që s'shuhën kurrë. Ata kanë për të ndriçuar në altarin e lirisë siç ndriçojnë yjet "mbi Akrokeraune".

Ai është Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës.

Kështu Labëria në Luftën Antifashiste i përjetoj këto ngjarje, i përjetoj dhe autori i poemës "Labëria magjike" dhe i sollti si një kujtesë, si një kod historik ku dallohen dhe shquhen në histori njerëzit dhe kohët. Lufta vërtet i mori heronjtë, por ajo dhe populli ju dha nder dhe dinjitet, ndau të mirën nga e keqja dhe i vendosi përsëri në pjedestalin e historisë.

Poeti dr. Neki Dredha, këtë këngë të poemës besoj që e ka pasur më të vështirë për ta "kënduar", por ja ka dalë, pasi heronjtë për të kanë qenë të rinj që në zemër kishin idealin e lirisë, ndaj dhe u sakrifkuan për të. Ishte Labëria që kishte këtë fuqi magjike, një realitet fisnik që dinte t'u këndonte trimave dhe trimreshave në kohë pushtimi dhe lufte.

Libri edhe këtyre episodeve të shkëputura, por të sjella me mjeshtëri dhe me magji nga dr. Neki Dredha, i japin veprës letrare një dinjitet dhe përjetësisht ngelën në histori.

## PROMOVIMI

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu përshëndet pjesëmarrësit dhe vlerëson veprën dinjotize të akademik Vasil S. Tole

## U PROMOVUA LIBRI

# “DHORA LEKA KOMPOZITORJA E PARË”

Halil RAMA- Mjeshtër i Madh

Njëqint vjet më parë, (më 23 shkurt 1925) lindi në Korçë kompozitorja e parë shqiptare Dhora Leka. Në këtë kuadër, në mjediset e Muzeut të Forcave të Armatosura u promovua libri i Prof. dr. Vaso S. Tole (akademik) “Dhora Leka, kompozitorja e parë”, botuar nga Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes, si si pjesë e veprimtarive të 80 vjetorit të çlirimit të atdheut.


Në këtë event mbresëlënës qindra pjesëmarrësit i përshëndeti Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, i cili vlerësoi këtë vepër dinjotize të akademik Vaso S. Tole, në të cilën jepen detaje njerëzore dhe profesionale të kompozitores së parë shqiptare Dhora Leka, autore në vitet “40 e këngëve të njohura partizane “Ato maja rripa-rripa, seç gjëmojnë”, “Rini-rini” etj, por që me gjithë meritat provoi barrën e rëndë të dënimit me 25 vjet burg dhe vetëm në vitin 1992 do t'i jepej titulli “Artiste e Popullit”.

Vlerat e kësaj veprë i evidentoi më së miri profesore Zana Shuteriqi.

Vetë autori, akademik Tole – Nënkyetar i Akademisë së Shkencave të RSH, përtej falenderimeve më të ngrohta për Ministrin Pirro Vengu dhe Ministrinë e Mbrojtjes, për familjen Leka, që i vuri në dispozicion materialet autentike të jetës dhe veprës së znj. Dhora etj, shprehu mirënjohje të thellë për qendrimet vlerësuese për librin të bëra nga dy personalitete të muzikës sonë, profesore Zana Shuteriqi dhe dirigjenti dhe muzikologu i shquar Eno Koco “Nderi i Kombit”.

### KOMPOZITORJA E PARË NË HAPËSIRËN MBARËSHQIPTARE

Akademik Vaso Tole, pasi përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit, në fjalën e tij u ndal në disa të vërteta që lidhen me Dhora Lekën dhe krijimtarinë e saj. Së pari ai evidentoi faktin që Dhora Leka është kompozitorja e parë në hapësirën mbarëshqiptare, e në një lloj kuptimi kompozitore që e bëri historia. “Në mënyrë të veçantë, këngët e krijuara prej saj, gjatë viteve të pushtimit fashist e nazist, konsiderohen si një kulminacion i krijimtarisë së saj e po ashtu etapa e fundit e repertorit muzikor patriotik shqiptar, ku përfshihen këngët për liri dhe pavarësi (1878 – 1912), ato të luftërave çlirimtare si të Vlorës më 1920-n dhe, më së fundi, këngët e Luftës Antifashiste (1939 – 1944)”, tha prof. Tole. Parë nga ky këndvështrim ai pohoi se koha i dha të drejtë shkrimtarit të shquar Dritëro Agolli kur shprehej për Dhora Lekën se: “... sa herë të bëhet përvjetori i Luftës Nacionalçlirimtare, sa herë të bëhen përvjetorë të tjerë të heronjve, të pjesëmarrësve të luftës, gjithmonë do të këndojnë këngët e Dhorës”. Kjo pasi, lëngët e kësaj peri-



• *Merrnin pjesë edhe Kryetarja e OBVLP Tatjana Parllaku-Çarkaxhiu, nënkryetari Kolonel Trifon Llupo dhe drejtues të tjerë të kësaj organizate*

udhe, çmohen dhe janë tashmë një nga format unikalë të trashëgimisë sonë artistike, bartëse të këtij shpirti të lirë shqiptar, të denja për të qenë në fondin më të mirë të kësaj muzike në nivel ndërkombëtar.

### E PARA KOMPOZITORE E PERSEKUTUAR GJATË KOMUNIZMIT NË TË GJITHË EUROPËN LINDORE

Në librin e akademik V. S. Tole evidentohet fakti se Dhora Leka nuk është vetëm kompozitorja e parë në hapësirën mbarëshqiptare, por është edhe e para kompozitore e persekutuar gjatë komunizmit në të gjitha vendet e Europës Lindore. “Nuk ka një rast të dytë jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën ish - komuniste që të gesh kompozitore të persekutuar. E kundërta ka ndodhur, që krijuese ose studiuese të muzikës kanë qenë të shkrira me sistemin ideologjik”, tha prof. Tole.

Ai solli në vëmendjen e pjesëmarrësve në këtë veprimtari promovuese kolege të Dhora Lekës, si polaken Zofia Lissa (1908-1980), e cila ishte autorja e atyre që njihen si gjashtë konkluzionet praktike që lidhnin muzikën me teorinë marksiste. Më konkretisht ai bëri të ditur këto konkluzione që konsistojnë në faktin që: Muzika vokale dhe programatike ishte më e rëndësishme se muzika instrumentale, që Muzika të trajtojë tema të përshtatshme me epokën e saj;

Ajo duhet të jetë melodike; Tonale;

E lidhur me temat popullore, si dhe e lidhur me traditat e mëdha muzikore kombëtare dhe evropiane, pa rënë në regresin e stilit të shekullit XIX.

Nëse kompozitorja ruse Aleksandra Pakhmutova, shoqe e saj e konservatorit CAJKOVSKI u shpall deri në Heroinë e Punës Socialiste në ish Bashkimin Sovjetik për krijimtarinë e saj, akademik Tole tha se te Dhora Leka, persekutimi la gjurmë të thellë në jetën e saj, pasi jo vetëm e shkëputi nga krijimtaria por edhe i nëpërkëmbi personalitetin. Për të qenë sa më bindës, prof. Tole perfrazoi vetë të Madhen Dhora Leka se: “... të gjithë më trajtonin si armik, kish raste që më kanë përplasur dhe derën në fytyrë, të atillë që më kanë shtrënguar fort dorën, të atillë që më kanë thënë je e marrë, krijimtaria jote nuk na duhet ti je armike”. Në anak,izëzn e tij prof. Toles, konkludon se ishte koha kur sipas Leonid Hellerit, “krijuesit duhet të udhëhiqeshin nga tri konceptet bazë të lidhura me realizmin socialist: nga angazhimi ideologjik ose ideinost, fryma kombëtare ose narodnost, dhe koncepti i partisë ose partiinost (party-ness), përmes të cilës vepra e artit të mbështeste në mënyrë agresive partinë dhe të ndihmonte në ngritjen e socializmit”.

### KOMPOZITORJA QË SHKROI DY OPERA, NJËRËN GJATË PERSEKUCIONIT DHE TJETRËN NË LIRI PAS VITEVE “90

Nga libri i akademik Vaso S. Tole

që bart vlera shumëdimensionale, veç të tjerësh mësojmë se Dhora Leka, përveçse kompozitorja e parë në hapësirën mbarëshqiptare, kompozitorja e parë e persekutuar, është edhe e para kompozitore që ka shkruar dy opera, njërën gjatë persekucionit dhe tjetrën në liri, pas viteve 1990.

Për fat të mirë, të dy këto vepra që lidhen me kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare janë vënë në skenën e Teatrit të Operas dhe Baletit duke plotësuar edhe dëshirat e saj.

Dhora ishte shumë e lidhur me to, bile ajo u nda nga jeta më 29 dhjetor 2007, pak muaj pas premieres së operas së dytë “Një jetë në stuhi”!

Si mik i zonjës Dhora dhe si autor i librit, prof. Tole ndjehet i nderuar që e dokumentoi jetën dhe veprën e saj artistike, si një dëshmi për të gjithë ata që duan të njihen me figurën e saj.

Kjo për faktin se “Dhora Leka do të mbetet në muzikën e gjysmës së parë të shek. XX si kompozitorja më e njohur e këngëve patriotike, që me fuqinë e artit të saj do të pohonte vlerat që mbart lufta e drejtë e një populli për liri dhe dinjitet”. Për këtë arsye, në 100-vjetorin e lindjes së kompozitores dhe 80-vjetorin e çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë, akademik Vaso S. Tole i përcjell ato përmes këtij botimi në nderim dhe vlerësim të kësaj trashëgimie muzikore unikalë.